

JANAR 2023 – 2027



RAPORTI I VLERESIMIT TE NEVOJAVE

DHE

PLANI SOCIAL LOKAL

Bashkia Krujë

PËRGATITUR NGA DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL KRUJË

PERMBAJTJA

HYRJE	5
METODOLOGJIA	6
PJESA E PARË.....	8
RAPORTI I VLERËSIMIT TË NEVOJAVE.....	8
1. KONTEKSTI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR NË BASHKI.....	8
1. 1 Legjislacioni dhe politikat kombëtare.....	8
1. Shërbimet parashoqërore.....	11
2. Shërbimet në familje	12
3. Shërbimet në komunitet	12
4. Shërbime rezidenciale	14
5. Shërbime të specializuara.....	15
1. 2. Financimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror.....	17
1. 3. Rolet dhe funksionet e Bashkisë në ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror	17
2. GJENDJA EGZISTUESE E STRUKTURAVE TË NJËSIVE VENDORE, SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR DHE INDIVIDËVE/GRUPEVE NË NEVOJË	20
2.1 Vështrim i përgjithshëm.....	21
Tabela 1. Numri i banorëve dhe familjeve në Bashkinë Krujë (rregjistri i gjendjes civile).....	21
Tabela 2. Popullsia banuese sipas gjinisë, grupmoshës sipas njësisë administrative (INSTAT, Census 2011)	21
2. 2. Të dhëna mbi organizimin dhe kapacitetet e stafit të Bashkisë	22
Tabela 3: Burimet njerëzore në njësitë administrative të Bashkisë Krujë	25
2.3. Të dhëna mbi individët/grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror	25
2.3.1 Personat me aftësi të kufizuar	25
Tabela 4: Personat me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative	26

2.3. 2 Familje përfituese të ndihmës ekonomike.....	26
Tabela 5: Familje në ndihmë ekonomike (viti 2018).....	26
2.3.3 Punëkërkuar të papunë.....	27
Tabela 6: Punëkërkuar të papunë.....	27
2.3.4 Fëmijët	27
2.3. 5. Viktima të dhunës në familje	28
2.3.6. Të moshuarit	28
4.3.7. Familje të pastreha	28
Tabela 7. Përmbledhtazi individë dhe grupe në nevojë	29
2.4. Të dhëna mbi shërbimet egzistuese të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë	29
2.4.1 Qendra sociale.....	29
Tabela 8: Qendra Ditore në Bashkinë Krujë.....	30
Tabela 9: Qendra rezidenciale në Bashkinë Krujë.....	31
2.4.2 Shërbimi në kopshte dhe çerdhe	31
Tabela 10. Shpërndarja e kopshteve dhe çerdheve në territorin e Bashkisë Krujë	32
2.4.3 Shërbimi shëndetësor	32
2.4.4 Shkollat	32
3. VLERËSIMI I NEVOJAVE	32
3. 1. Nevojat për organizimin dhe strukturat e njësisë vendore	32
3.1.1 Organizimi në Bashki.....	33
Rekomandim 1:.....	33
Rekomandim 2:.....	33
3.1.2 Niveli i njësisë administrative	33
Tabela 11: Ngarkesa e punës së administratorit shoqëror dhe paaftësisë në njësitë administrative ...	34
Rekomandim 3:.....	35
Rekomandim 4:.....	35
Rekomandim 5:.....	35
Rekomandim 6:.....	35

Rekomandim 7:.....	36
Rekomandim 8:.....	36
Rekomandim 9:.....	36
3. 2. Nevojat për ngritjen e kapaciteteve të stafit	36
Rekomandim 10:.....	37
3. 3. Nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror.....	37
Rekomandim 11: Ngritja dhe funksionimi i shërbime të kujdesit shoqëror	39
Rekomandim 12: Ngritja dhe funksionimi i nje qendre ditore per fëmijet ne Njesine	
Administrative Fushe Kruje.....	40
PJESA E DYTË	42
PLANI SOCIAL I BASHKISË KRUJË	42
1. Vizioni, parimet dhe qëllimet.....	42
1.1 Vizioni	42
1.2 Parimet.....	42
1.3 Qëllimet specifike	42
2. Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi.....	46
2.1 Zbatimi.....	46
2. 2. Monitorimi dhe vlerësimi.....	47
PLANI SOCIAL BASHKIA KRUJË	48
BUXHETI SIPAS OBJEKTIVAVE	79
REFERENCA	82

HYRJE

Plani Social i Bashkisë Krujë u përgatit nga Drejtoria e Shërbimit Social Krujë për një periudhë kohore 4 vjeçare. Qëllimi kryesor i përgatitjes së Planit Social është mbështetja e Bashkisë në mënyrë që të garantohet mbrojtja e fëmijëve dhe familjeve në territorin e saj, si dhe e grupeve vulnerabël në përgjithësi.

Përgatitja dhe zbatimi i Planit Social Lokal është detyrim ligjor i njësive të vetëqeverisjes vendore në përputhje me Ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri”.

Reforma e shërbimeve shoqërore e zhvilluar paralelisht me reformën territoriale të vitit 2015, ndryshimet e rëndësishme ligjore që kanë ndodhur veçanërisht dy vitet e fundit me miratimin e Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror” si dhe ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” kanë krijuar kuadrin e përshtatshëm ligjor për të bërë të mundur **ngritjen dhe funksionimin e sistemit të mbrojtjes dhe përkujdesit shoqëror për grupet vulnerabël në tërësi dhe fëmijët në veçanti në nivelin vendor.**

Shërbimet e përkujdesit shoqëror luajnë një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së jetës të individëve, familjeve dhe komuniteteve rom dhe egjiptian si dhe komuniteteve të ndryshme në nevojë. Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale, përcakton vizionin për këto shërbime: *“Vizioni ynë për këto shërbime është një sistem i integruar përkujdesi shoqëror që është koherent dhe i qëndrueshëm në nivel strategjie, politikash, buxhetesh dhe kapacitetesh¹”.*

“Shporta” e shërbimeve të kujdesit shoqëror, e rregulluar me një akt të veçantë të Këshillit të Ministrave përmban shumëllojshmëri shërbimesh në të cilat përfshihen : *shërbimet parashoqërore, shërbimet në familje, shërbimet në komunitet, shërbimet rezidenciale dhe shërbimet e specializuara.*

Dokumenti në vijim është i organizuar në dy pjesë:

- ✓ *Pjesa e parë* përmban Raportin e Vlerësimit të Nevojave, i cili jep të dhëna të detajuara mbi situatën egzistuese në këndvështrimin e (i) organizimit, strukturave dhe kapaciteteve të stafit lokal të shërbimeve të kujdesit shoqëror, (ii) individëve dhe grupeve në nevojë në territorin e Bashkisë Krujë, (iii) shërbimeve egzistuese në territor. Raporti përfshin situatën e fëmijëve në Bashki, pasi Plani i Mbrojtjes së Fëmijëve do të jetë pjesë integrale e Planit Social që u përgatitet. Kjo pjesë përmban rekomandime specifike për ndryshimin e situatës së ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Krujë

¹ Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale

mbi bazën edhe të konsultimeve të kryera me aktorët publik e jo publik në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

- ✓ *Pjesa e Dytë* përmban Planin Social të Bashkisë Krujë, i hartuar mbi bazën e nevojave për shërbime të identifikuar të individëve dhe grupeve në nevojë në territorin e Bashkisë, kuadrin ligjor, strategjitë dhe standartet kombëtare specifike, si dhe politikat lokale të zhvillimit.

Ky Plan Veprimi u planifikua për të qenë njëherazi një mjet drejtimi për një periudhë katër vjeçare, si dhe një mjet i menaxhimit të përditshëm të angazhimeve të strukturave përgjegjëse me zbatimin e tij. Ky plan do ti ndihmojë strukturat përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të tij që të fokusohen në përmbushjen e tyre dhe të sjellin rezultatet e dëshiruara.

METODOLOGJIA

Për vlerësimin e nevojave në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Krujë u përdorën teknika të ndryshme të kërkimit, analizës dhe vlerësimit ku përfshihen:

1. Hulumtimi i dokumentave strategjike kombëtare dhe legjislacionit kombëtar, pasi politikat lokale duhet të respektojnë legjislacionin dhe standartet kombëtare².
2. Hulumtimi i dokumentave strategjike lokale dhe rregullores së njësisë së qeverisjes vendore.
3. Identifikimi dhe zbatimi i instrumentave të nevojshme për të vlerësuar situatën aktuale në Bashkinë Krujë në këndvështrimin e individëve dhe grupeve në nevojë për shërbime, si dhe shërbimeve egzistuese në territorin e Bashkisë. Të dhënat kryesore të mbledhura përfshijnë:
 - a) Të dhëna demografike bazë;
 - b) Profili dhe karakteristikat e përdoruesve të shërbimit;
 - c) Shërbimet egzistuese në territorin e Bashkisë ose që përfshin dhe Bashkinë;
 - d) Shpërndarja e shërbimeve në territor;
 - e) Financimi i shërbimeve aktuale;
 - f) Të dhëna mbi strukturat e ngritura në Bashki dhe njësi administrative në përputhje me ligjin;
 - g) Të dhëna krahasuese mbi buxhetin e Bashkisë për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe shpërndarjen e tij;
4. Pas përgatitjes së paketës më të dhënat e nevojshme që duheshin mbledhur në funksion të përgatitjes së Raportit të Vlerësimit të Nevojave u zhvillua një workshop me grupin lokal

² Ne seksionin “Referenca” gjeni paketën e plotë të konsultuar për përgatitjen e Planit Social të Bashkisë Krujë

me qëllim informimin e tij mbi hapat e procesit të përgatitjes së planit social, sqarimin e metodologjisë që do të përdorej për mbledhjen e të dhënave dhe kryerjen e analizës, së bashkë me qartësimin e rolit të tyre në këtë proces.

5. U realizua një intervistë gjysëm e strukturuar me strukturën lokale të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
6. Të dhënat e mbledhura nga grupi lokal, si dhe hulumtimi i strategjive kombëtare e lokale, bashkë me intervistën e zhvilluar mundësuan përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Nevojave.
7. Raporti i vlerësimit të nevojave shërbeu si një bazë e rëndësishme në procesin e përgatitjes së Planit Social të Bashkisë Krujë dhe bashkë me Planin Social u konsultua gjerësisht me aktorët lokal publik dhe jopublik dhe specifikisht:
 - ✓ Bashkia Krujë/ strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe njësitë administrative;
 - ✓ Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Qarkun e Durrësit;
 - ✓ Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror;
 - ✓ Ofrues publik dhe jo publik të shërbimeve egzistuese të kujdesit shoqëror në Bashkinë Krujë;
 - ✓ Organizata joqeveritare që punojnë në territorin e Bashkisë dhe/ose Qarkut me projekte në fushën e kujdesit shoqëror dhe mbrojtjes sociale;
 - ✓ Përfaqësues nga sistemi arsimor;
 - ✓ Përfaqësues nga sistemi shëndetësor;
 - ✓ Përfaqësues nga policia;
 - ✓ Përfaqësues nga Prokuroria
 - ✓ Përfaqësues nga Dega Territoriale e Shërbimit të Proves Kruje

Kufizimet:

Ky Plan u përgatit sipas Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror” , Ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligji nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” ku kanë krijuar kuadrin e përshtatshëm ligjor për të bërë të mundur **ngritjen**

dhe funksionimin e sistemit të mbrojtjes dhe përkujdesit shoqëror për grupet vulnerabël në tërësi, familjet në nevojë , moshë e tretë , gratë e dhunuara dhe viktimat e mundshme të trafikimit, komuniteti rom dhe egjiptjan, invalidet e punës, personat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në veçanti.

Në procesin e mbledhjes së të dhënave, saktësia e të cilave përbën bazë të rëndësishme për të identifikuar nevojat për shërbime dhe për vetë përgatitjen e Planit Social, u ndeshën sfida dhe specifikisht:

- ✓ mungesa e të dhënave zyrtare për disa grupe në nevojë që edhe pse ekzistojnë, nuk rregjistrohen të dhëna për ta.
- ✓ mungesa e qasjes së strukturave egzistuese përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror për ti identifikuar individët në nevojë drejtpërdrejtë në terren dhe jo thjesht kur ata që kanë nevojë për shërbime të drejtohen vetë tek strukturat vendore, gjë që nuk mundëson të dhëna reale mbi individët në nevojë dhe numrin real të tyre.
- ✓ Mungesa e funksionimit të sistemesë të shërbimeve shoqërore të cilat janë të identikuara për një sistem të integruar të dhënash. Këto sisteme janë hapur por nuk funksionojnë për shkak të mos mirëmbajtjes së tij dhe mos azhurnimit të të dhënave të freskuara.
- ✓ Mungesa e një grupi kontrolli dhe monitorimi për punonjësit që ushtrojnë funksionet e ofrimit të shërbimeve shoqërore që përfshijnë mbrojtjen e fëmijëve dhe dhunën në marrëdhëniet familjare.

Konsultimi me aktorë të ndryshëm nxorri në pah faktin që numri i individëve në nevojë në disa grupe vulnerabël është më i lartë se sa shifrat e raportuara. Përmirësimi i mbledhjes së treguesve statistikor është një çështje që adresohet në Planin Social të Bashkisë Krujë.

PJESA E PARË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NEVOJAVE

1. KONTEKSTI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR NË BASHKI

1.1 Legjislacioni dhe politikat kombëtare

Reforma e shërbimeve shoqërore e zhvilluar paralelisht me reformën territoriale të vitit 2015, ndryshimet e rëndësishme ligjore që kanë ndodhur veçanërisht dy vitet e fundit me miratimin e Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror” si dhe ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” kanë krijuar kuadrin e përshtatshëm ligjor për të bërë të mundur **ngritjen dhe funksionimin e sistemit të mbrojtjes dhe përkujdesit shoqëror për grupet vulnerabël në tërësi dhe fëmijët në veçanti në nivelin vendor.**

Shërbimet e përkujdesit shoqëror luajnë një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së jetës të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë. Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale, përcakton vizionin për këto shërbime: *"Vizioni ynë për këto shërbime është një sistem i integruar përkujdesi shoqëror që është koherent dhe i qëndrueshëm në nivel strategjie, politikash, buxhetesh dhe kapacitetesh"*³.

Shërbimet e përkujdesit shoqëror duhet të shenjestrojnë kategoritë më të rrezikuara nga varfëria apo përjashtimi social, duke synuar mbulimin e tyre me shërbime mbështetëse, reabilituese dhe rinintegruese. Strategjia ka përcaktuar si prioritet ngritjen e shërbimeve komunitare në përputhje me nevojat e identifikuar për shërbime, të shoqëruar me reduktim të kujdesit rezidencial. Ajo thekson se "deinstitucionalizimi mbetet një sfidë, pasi kërkon krijimin e një rrjeti shërbimesh në territor, strukturim të proceseve dhe procedurave për menaxhimin e rasteve dhe rritje kapacitetesh të profesionistëve⁴. Në këto kushte Bashkitë si aktorët kryesorë në ngritjen dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel komunitar duhet të kenë kapacitetet e nevojshme veçanërisht në drejtim të planifikimit, organizimit, administrimit dhe kontrollit të shërbimeve të përkujdesit. Nje nga sfidat me te medha te deinstitucionalizimit, qe eshte shperndarja e sherbimve shoqerore dhe marrja e tyre ne komunitet, na perball me nje mungese perгатitje te ofrimit dhe marrjes se te ketyre sherbimve ne natyre.

Ligji nr.121, datë 21.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij rregullojnë funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe në mënyrë të posaçme procesin e ofrimit të shërbimeve nga organet publike në nivel vendor të ngarkuara sipas Ligjit.

Këto shërbime mund të ofrohen drejtpërdrejtë nga një ofrues publik (Bashkia, Qarku apo SHSSH) ose nga ofrues jopublik. Këta të fundit i ofrojnë shërbimet përmes financimit nga donacione jopublike/ në formën e biznesit/financimit nga fondet publike duke ndjekur procedurat e prokurimit publik. Në mënyrë të veçantë kur mungojnë shërbimet e ngritura nga institucionet publike, këto shërbime duhet të kontraktohen nga organizatat jo-fitimprurëse apo ofrues të tjerë të shërbimeve. Kjo do të zvogëlonte kostot e ngritjes (set-up dhe kohën) dhe do të lejonte fleksibilitet më të madh në ofrimin e shërbimit.

“Shporta” e shërbimeve të kujdesit shoqëror, e rregulluar me një akt të veçantë të Këshillit të Ministrave përmban shumëllojshmëri shërbimesh në të cilat përfshihen : *shërbimet*

³ Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale, fq.4

⁴ Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale, fq.16

parashoqërore, shërbimet në familje, shërbimet në komunitet, shërbimet rezidenciale dhe shërbimet e specializuara.

Një kategori e vecantë që kanë nevojë të domosdoshme për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje të barabartë është edhe komuniteti Rom dhe Egjyptiane.

Komuniteti Rom dhe Egjyptian përballen me një sërë sfidash në lidhje me strehimin, aksesin në shërbime sociale dhe arsimim, në Bashkia Kruje po punon në mënyrë të vazhdueshme për përfshirjen dhe fuqizimin e tyre në skemat shoqërore. Në territorin e Bashkisë Kruje banojnë **140 familje rome** (0,6 % e familjeve janë rome) dhe **166 familje egjiptiane** (0,7 % e familjeve janë egjiptiane).

Popullsia rome dhe egjiptiane është e përqëndruar kryesisht në Njesinë Administrative Fushë-Krujë.

Nje nga strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashki është Drejtoria e Shërbimit Social.

Sipas Rregullores kjo drejtori mes te tjerave ka si mision:

1. Të evidentojë grupet në nevojë brenda territorit të bashkisë dhe të krijojë, brenda kuadrit ligjor, kushtet e favorshme për t'iu ofruar ndihmën e nevojshme ekonomike dhe shërbimin e duhur social familjeve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuara;
2. Të hartojë programe veprimi afatmesëm dhe afatgjatë, në zbatim të strategjive kombëtare dhe vendore, për zbutjen e varfërisë, integrimin e pakicave, implementimin e projekteve publike etj.

Këto dy pika janë të rëndësishme dhe gjithëpërfshirëse për kategorinë e Komunitetit Rom dhe Egjyptian, pasi qëllimi jonë është përfshirja e tyre në programe sociale mbështetëse me qëllim rritjen e nivelit të tyre të jetesës në cdo fushë.

Në Njesinë Administrative Fushë – Krujë është ngritur dhe funksionon një Qendër Ditore ” Porta Roma” e cila ka në fokus fëmijë jashtë kujdesit prindëror, fëmijë me aftësi të kufizuara, viktimë të dhunës, individë në nevojë, të gjithë pjesë e komunitetit rom dhe egjiptian. Shërbimi që ofron kjo qendër fokusohet në :

- Regjistrim civil për komunitetin rom.
- Statistikë për komunitetin rom dhe egjiptian.
- Shërbim psikosocial.

- Shërbime punësimi.

Shërbimi ofrohet nga katër punonjës për 6 orë në ditë.

Specifikisht:

1. Shërbimet parashoqërore janë shërbimet që mundësojnë rehabilitimin dhe riintegrimin e sa më të shpejtë të individëve apo familjeve në nevojë dhe përfshijnë:

a) **Informimin dhe këshillimin**, i cili siguron informimin mbi shërbimet që ekzistojnë në përputhje me nevojat, këshillimin, orientimin dhe referimin drejt shërbimeve specifike që synojnë rehabilitimin, riintegrimin, fuqizimin ekonomik dhe social dhe i'u ofrohet:

- i. familjeve në ndihmë ekonomike;
- ii. personave me aftësi të kufizuara;
- iii. çdo individ në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror;
- iv. grave dhe vajzave me probleme sociale;
- v. viktimat e dhunës, trafikimit dhe varësisë së provuar ndaj drogës e alkoolit;
- vi. të moshuarit në nevojë që nuk është i aftë të kujdeset për veten, apo janë të braktisur.
- vii. komunitetin romë dhe egjiptian.

b) **Ndërhyrja e hershme** është shërbim individual që ofrohet në familje, në qendra sociale për ofrimin e shërbimeve në komunitet, në institucionet e arsimit të detyrueshëm, apo institucion mjekësor sipas karakteristikave të fëmijës dhe siguron:

- i. ndihmën profesionale dhe stimuluese për fëmijët deri në 8 vjeç;
- ii. asistencën këshilluese për prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes me lidhje gjaku ose për familjen kujdestare, me qëllim riintegrimin në shoqëri të fëmijës.

c) **Këshillimi për punësim** siguron rritjen e aftësive dhe përfshirjen në tregun e punës së punëkërkuesve të papunë përmes:

- i. këshillimit për proceset e punësimit;
- ii. vlerësimit individual, ngritjes së kapaciteteve;
- iii. zbatimit të ciklit të këshillimit me ofruesit publik, shoqërisë civile dhe sektorit privat.

ç) **Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line** siguron mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje dhe mbrojtjes së fëmijëve, në përputhje me standardet dhe protokollet e funksionimit të mratuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale. Ky shërbim ofrohet nëpërmjet:

- i. linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës;
- ii. faqes on-line të krijuar në nivel vendor dhe/ose kombëtar.

2. **Shërbimet në familje** janë shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në familje për kategoritë në nevojë të cilat e kanë të pamundur të marrin shërbime komunitare, ditore dhe rezidenciale, dhe përfshijnë:

a) **Shërbimi në shtëpi**, i cili siguron integrimin e shërbimeve të kujdesit ditor që i'u ofrohet në familje fëmijëve, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara, komunitetit rom dhe egjiptian të cilët janë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari dhe përfshin:

- i. furnizimin dhe shpërndarjen e ushqimeve të gatshme në shtëpi;
- ii. furnizimin e barnave apo furnizime të tjera jetike;
- iii. mbajtjen e higjienës personale;
- iv. përmbushjen e nevojave të tjera të përditshme, sipas vlerësimit, rast pas rasti;
- v. shërbime rehabilitimi, zhvillimi, këshillim psikologjik e ligjor sipas rastit.

b) **Shërbimi i ndihmës personal** siguron mbështetje personale në cilësinë e ndihmës për kujdesin personal për:

- i. personat me aftësi të kufizuara;
- ii. personat e verbër;
- iii. interpretuesit e gjuhës së shenjave;
- iv. lehtësuesit në komunikim për personat me paaftësi në të folur dhe në të dëgjuar.
- v. Kur është e nevojshme në këtë shërbim përfshihet edhe formimi i personit me aftësi të kufizuar për të mësuar se si të udhëzojnë ndihmës personal.

c) **Shërbimi i transportit social** siguron transport specifik për individin që ka të nevojshëm transportin për të punuar, studiuar, por që aftësia e kufizuar i pengon për të përdorur një mjet personal apo transportin publik. Ky shërbim është i nevojshëm për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara përdorues të karriges me rrota ose dëmtime shikimi që nuk e lejojnë të drejtojnë vetë makinën.

ç) **Shërbimi i përkujdesjes alternative** siguron zhvillimin, arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës dhe i ofrohet fëmijës kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në një mjedis familjar të caktuar, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi. Shërbimi ofrohet për:

- i. fëmijës pa kujdes prindëror;
- ii. fëmijës së privuar në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nga mjedisi familjar

3. **Shërbimet në komunitet** ofrohen në qendra komunitare lokale ose në mjedise të tjera dhe në çdo rast përfshijnë shërbimet që mundësojnë kujdesin ditor apo të zëvendësimit të

përkohshëm të kujdestarit për të gjitha kategoritë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe në to përfshihen:

a) **Mbështetja psiko-sociale** i ofrohet çdo individ sipas nevojave të vlerësuara dhe të referuara nga Njësia e Vlerësimit të Nevojës dhe Referimit të Rastit, individualisht ose në grup dhe siguron:

- i. inkurajimin;
- ii. rehabilitimin;
- iii. zhvillimin e aftësive njohëse, funksionale, komunikuese apo shoqërore të përfituesve.

b) **Qendra komunitare** është shërbim multifunksional mbështetur në shumëllojshmërinë e shërbimeve dhe grupeve, të cilët i marrin këto shërbime dhe siguron:

- i. shërbime për rehabilitimin fizik dhe psiko-social;
- ii. këshillime për prindërimin, punësimin, edukimin shëndetësor, edukimin, kalimin e kohës së lirë;
- iii. fuqizimin e individit/familjes;
- iv. çdo shërbim tjetër të nevojshëm të identifikuar nga Plani Social i Bashkisë.
- v. stafet e profesionistëve brenda ngarkesës së tyre të punës kryejnë edhe shërbime që lidhen me paketën e shërbimit në familje.

c) **Qendrat ditore** ofrojnë shërbim gjysëmditor ose të plotë ditor, i cili mund të përdoret një ose disa ditë në javë dhe sigurojnë shërbime specifike sipas kategorisë së përfituesve:

- i. fëmijë që jetojnë në situatë rruge dhe fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike - Shërbimet për këtë kategori përfshijnë ushqim, mbështetje për edukim, mbështetje psikologjike dhe sociale, aktivitete të kohës së lirë që nxisin edukimin dhe integrimin;
- ii. fëmijët me aftësi të kufizuara - Shërbimet për këtë kategori përfshijnë terapi zhvillimi, fizioterapi, logopedi, ortofoni, terapi okupacionale, mbështetje psikologjike, përkujdesje fizike, ushqim për qëndrimin ditor;
- iii. të moshuarit - Shërbimet për këtë kategori përfshijnë mbështetje psikologjike, kujdes shëndetësor, aktivitete të kohës së lirë, përfshirje në komunitet dhe ushqim.

ç) **Shërbimi i emergjencës 72 orë** i ofrohet individëve që kanë nevojë për asistencë të menjëherëshme për shkak të një situate, që i'u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëherëshme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur. Ky shërbim është ngritur për ato kategori të identifikuara në risk sipas Planit Social, por vecanërisht shërbime emergjence ngrihen për:

- i. viktimat të dhunës në familje dhe fëmijët;
- ii. fëmijët pa kujdes prindëror ose të dhunuar, shfrytëzuar, abuzuar, dhe fëmijë me aftësi të kufizuara;

- iii. të moshuarit apo individët të braktisur në situatë rruge.
- d) **Shërbimi për të pastrehët** ofrohet për individë mbi 18 vjeç që nuk kanë strehë banimi dhe janë në vështirësi ekonomike dhe siguron:
- i. strehim gjatë natës;
 - ii. muncë;
 - iii. mbështetje me këshillim dhe referim për fuqizim dhe riintegrim sa më të shpejtë.
- dh) **Shërbimi për fëmijët në konflikt me ligjin** krijohet dhe funksionon për të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, sipas vlerësimit të kryer nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit dhe referimit në shërbimet specifike sipas nevojave të identifikuar të fëmijëve që:
- i. kanë përfunduar periudhën e dënimit;
 - ii. kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror me qëllim riintegrimin në shoqëri;
 - iii. gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare me vendim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë.
- e) **Shërbimi i strehimit të mbrojtur** i ofrohet viktimave të dhunës në familje, viktimave të trafikimit dhe personave me aftësi të kufizuara të cilët nuk kanë një strehë. Ai organizohet në formën e një strukture banimi të veçantë, sipas specifikave të grupit të përfituesve ose në formën e banesave individuale, si dhe siguron:
- i. paketa ushqimore, trajtim psikologjik dhe emocional, këshillim dhe referim tek shërbimet rehabilituese, riintegruese në tregun e punës dhe fuqizuese, për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit, në përputhje me vlerësimin e kryer për nevojat e tyre;
 - ii. mbështetje për jetesë brenda dhe jashtë ambientit të banimit, terapi rehabilituese, këshillim dhe mbështetje për integrim në tregun e punës për personat me aftësi të kufizuara.
- 4. Shërbime rezidenciale** janë shërbimet që ofrohen në qendrat rezidenciale dhe në çdo rast përfshijnë të paktën shërbime të kujdesit njëzetekatër orësh dhe afatgjatë për individë në nevojë, fëmijë ose të rritur. Në këtë shërbim përfshihen:
- a) **Shërbime në qendrat e zhvillimit** që sigurojnë përmirësimin e statusit dhe cilësisë së jetës së individëve me aftësi të kufizuara, deri në 21 vjeç dhe përfshijnë:
- i. terapi intensive psiko-sociale për aftësimin mendor dhe rehabilitimin social me qëllim integrimin në komunitet;
 - ii. shërbim psiko-motor për aftësimin dhe përmirësimin e parametrave psikologjikë dhe të motorikës fine e globale;
 - iii. aftësim i parametrave fizikë;

- iv. shërbime specifike ortofonie për aftësimin e individëve me çrregullime të spektrit autik apo aftësisë për të komunikuar;
- v. terapi riaftësimi për punë;
- vi. terapi zhvillimi.

b) **Strehimi afatgjatë**, i cili i sigurohet individit që ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm, me qëllim përmbushjen e nevojave themelore. Ky shërbim i ofrohet:

- i. personave me aftësi të kufizuara, sipas moshës, llojit dhe shkallës së dëmtimit, kur nuk është e mundur të sigurohet kujdesi në familje apo familje kujdestare, duke i dhënë formën e duhur të kujdesit;
- ii. të moshuarve dhe të sëmurëve rëndë, të cilët vuajnë nga ndryshime të përhershme të gjendjes shëndetësore, kur nuk është e mundur të sigurohet kujdesi në familje apo familje kujdestare.

c) **Shërbimi në strehëza**, u siguron përfituesve shërbim specifik, strehimin, sigurinë fizike, ushqimin, kujdesin shëndetësor, rehabilitimin psiko-social, terapinë fizike, aktivitete profesionale, kalimin e kohës në komunitet, edukimin, në varësi të nevojave të identifikuara dhe të zgjedhura nga përfituesit. Ky shërbim ofrohet në mënyrë të përkohshme për:

- i. fëmijën që gjendet i pambikëqyrur nga prindërit, në rrezik, apo në situatë rruge;
- ii. fëmijën në nevojë të mbrojtjes së veçantë;
- iii. të rriturin, ose të moshuarin që nuk ka vendbanim të përhershëm apo të përkohshëm dhe nuk është në gjendje të kujdeset për veten;
- iv. gratë dhe vajzat shtatzëna ose për prindin e vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç;
- v. fëmijën dhe të rriturin viktimë të dhunës në familje, abuzimit, viktimë të trafikimit apo viktimë të mundshme të trafikimit ose në rrezik të mundshëm për jetën;
- vi. fëmijën dhe të rriturin në rrezik për shkak të situatës shëndetësore, aftësisë së kufizuar, varësisë nga droga ose alkooli apo përjashtimit social.

5. Shërbime të specializuara janë shërbimet që ofrohen në nivel kombëtar, rajonal apo bashkie nga profesionistë të specializuar në fusha të caktuara dhe përfshijnë:

a) **Shërbime zhvilluese dhe rehabilituese** publike dhe jopublike që ofrohen në territorin e bashkisë ose në territorin e rajonit për fëmijë me:

- i. çrregullime pervazive të zhvillimit;
- ii. prapambetje mendore;
- iii. çrregullime në komunikim;
- iv. në nevojë për aftësim fizik.

- b) **Rehabilitim për viktimat e abuzimit seksual** ofrohet për viktimën e abuzimit seksual. Kur vlerësohet se jeta në familje mund të vijojë pa ndërprerje, shërbimet rehabilituese, terapistë për rehabilitim shëndetësor dhe psikologjik dhe çdo nevojë tjetër e identifikuar për viktimën e abuzimit seksual, ofrohen nga shërbimet ekzistuese komunitare. Shërbimi i specilizuar siguron:

- i. strehimin;
- ii. sigurinë fizike;
- iii. ushqimin;
- iv. terapi dhe rehabilitim psikologjik;
- v. kujdesin shëndetësor;
- vi. asistencën juridike;
- vii. shërbime ri-integruese.

- c) **Strehëza për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje** ofron shërbim në mënyrë të përkohshme në varësi të nevojave të identifikuara dhe të zgjedhura nga përfituesit, viktimat të dhunës në familje që kanë marrë Urdhër Mbrojtje apo Urdhër të menjëhershëm mbrojtje dhe siguron:

- i. strehimin;
- ii. sigurinë fizike;
- iii. ushqimin;
- iv. kujdesin shëndetësor;
- v. asistencë juridike;
- vi. rehabilitimin psiko-social;
- vii. fuqizim për punësim.

- ç) **Qendra për mbrojtjen, trajtimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit** ofron shërbim në mënyrë të përkohshme dhe mundëson:

- i. strehimin;
- ii. sigurinë fizike;
- iii. ushqimin;
- iv. kujdesin shëndetësor;
- v. asistencën juridike;
- vi. rehabilitimin psiko-social, në varësi të nevojave të identifikuara të viktimës së trafikimit.

- d) **Shërbim rehabilitimi për personat me varësi nga droga** në nivel komunitar ofrohet si shërbim ditor që përfshin shërbime rehabilituese sipas nevojave të identifikuara nga njësitë e specializuara mjeksore dhe nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit. Në kushtet rezidenciale shërbimi ofrohet në mënyrë të përkohshme dhe përfshin shërbimet:

- i. rehabilitues;
- ii. strehimin;

- iii. ushqimin;
- iv. kujdesin shëndetësor;
- v. rehabilitimin psiko-social;
- vi. terapi okupacionale në varësi të nevojave të identifikuara të përfituesve të shërbimit.

dh) **Shërbim i specializuar për përdoruesit e karrigeve me rrota**, kryhet nga profesionistë të specializuar për këtë lloj shërbimi, i ofrohet personave me aftësi të kufizuar dhe siguron pas vlerësimit të karakteristikave fizike të individit në nevojë:

- i. prodhimin e karrigeve me rrota; dhe
- ii. montimin e karrigeve me rrota.

1. 2. Financimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

Në këndvështrimin e financimit ligji dhe aktet nënligjore ngrenë fondin social i cili, në përputhje me nenin 47 të ligjit⁵ përbëhet nga:

- a) të ardhurat vjetore nga Buxheti i Shtetit;
- b) financime jashtëbuxhetore nga organizata vendase apo të huaja ose persona të tjerë;
- c) të ardhurat nga zbatimi i tarifave për shërbime të ndryshme të kujdesit shoqëror;
- ç) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- d) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron bashkia.

Në përputhje me draft VKM "Për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror" paraqitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale gjatë konsultimit me grupet e interesit në Dhjetor 2022⁶, për të përfituar fonde nga Buxheti i Shtetit Bashkitë duhet të hartojnë Planin Social Lokal katër vjeçar, të bazuar në nevojat e identifikuara për shërbime të kujdesit shoqëror. Plani duhet të jetë i buxhetuar dhe për çdo shërbim Bashkia duhet ti referohet kostos për njësi të shërbimit specifik të përcaktuar nga Ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale, vlerësim që kryhet nga kjo e fundit mbi bazën e standartit kombëtar për shërbimin specifik.

1. 3. Rolet dhe funksionet e Bashkisë në ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror

Në zbatim të përcaktimit të nenit 36 dhe nenit 52, pika 1, të Ligjit 121/2016, **Bashkitë sigurojnë:**

- a) Krijimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e juridiksionit të tyre, mbështetur në Planet Sociale të miratuara paraprakisht nga Këshilli Bashkiak, të cilat analizojnë të paktën:

⁵ Ligji 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", neni 47

⁶ Shih Shtojca 1 prezantimi i MSHMS për draftin e konsultuar

- i) kategoritë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
 - ii) madhësinë e grupeve shoqërore që kanë nevojë për shërbimin specifik; dhe
 - iii) koston për mbulimin e shërbimeve të nevojshme, sipas përcaktimit të standardit kombëtar përkatës.
- b) Vlerësimin e nevojave të individëve për shërbime të kujdesit shoqëror, përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm që mundëson përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror nga individ; propozimin për miratim nga Këshilli Bashkiak përkatës, të shërbimit specifik për individin në nevojë në rastet kur shërbimi ofrohet në territorin e juridiksionit të bashkisë ose referimin në shërbime të ngritura në nivelin e qarkut.

Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror, e krijuar pranë Bashkisë, siguron të paktën:

- a) identifikimin e nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin në juridiksionin e bashkisë,
- b) vlerësimin e nevojës për shërbime të kujdesit shoqëror, sipas hartës së vulnerabilitetit;
- c) hartimin e projekt Planit Social vendor duke kostuar shërbimet e nevojshme të identifikuara, si dhe përgatitjen e Programit Buxhetor vjetor përkatës, për miratim në këshillin bashkiak;
- ç) planifikimin e kalendarit të shpërndarjes vjetore dhe sigurimin e ofrimit të paketës bazë të shërbimeve të kujdesit shoqëror gjatë një viti;
- d) ofrimin e shërbimeve shoqërore nëpërmjet: i) kontraktimit të realizimit të shërbimeve nga sektori privat; ii) krijimit dhe shfrytëzimit të shërbimeve publike;
- dh) ngritjen dhe zbatimin e sistemit të administrimit të performancës së shërbimit, bazuar mbi standarde vendore dhe standarde minimale kombëtare të cilat miratohen me Udhëzim të Ministrit përgjegjës për çështjet sociale;
- e) hartimin dhe zbatimin e sistemit të treguesve për matjen e performancës, në të cilin përfshihen edhe tregues të aspektit gjinor;
- ë) krijimin e sistemit të mbikëqyrjes së shërbimeve në territorin e bashkisë;
- f) propozimin e përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror për miratim nga Këshilli Bashkiak.

Ndërkohë kjo strukturë kryen dhe funksione që lidhen me administrimin e pagesave cash të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, sikurse në përputhje me VKM **Nr.334, datë 17.2.2011** “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” **ka në përbërje të saj edhe koordinatorin vendor për adresimin e dhunës në familje**. Në përputhje me me ligjin "Për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve" në nivelin e Bashkisë është ngritur Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, që ka role dhe detyra specifike për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e plotë të të drejtave të tyre. Koncretisht:

1. Nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.334, datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” **lind detyrimi për ngritjen dhe funksionimin e :**

- ✓ **Komiteteve Drejtuese Lokale** që drejtohen nga Kryetari i Bashkisë dhe janë komitetekoordinuese ad hoc;
- ✓ **Ekipi teknik ndërdisiplinor** që ngrihet me vendim të komitetit drejtues më qëllim bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse në nivel vendor në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje;
- ✓ Pranë çdo bashkie caktohet **koordinatori vendor** për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, i cili është përfaqësuesi i zyrës së shërbimeve sociale pranë asaj njësie të qeverisjes vendore ;

Në përputhje me **ligjin Nr.9669, datë 18.12.2006 (ndryshuar) “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” njësitë e qeverisjes vendore kanë këto detyra:**

- a) angazhimin në krijimin e strukturave të shërbimit social për rastet e dhunës në familje;
- b) instalimin e një linje telefonike rajonale 24-orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore dhe OJF-të, duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre;
- c) ngritjen e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit, si dhe koordinimin e punës me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse.

2. Në këndvështrimin e *garantimit të mbrojtjes që duhet ti mundësohet çdo fëmijë*, Ligji⁷nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” përcakton mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, bashkë me detyrat specifike që garantojnë ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave me efektivitet, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës. Në kreun III “Mekanizmat institucional për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, neni 34 përcakton si mekanizëm këshillimor dhe koordinues institucional në nivelin vendor grupin teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative. Ndërkohë **strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor janë:**

- a) Bashkia;
- b) **Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;**
- c) **Njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;**
- d) **Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësive administrative;**
- e) **Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.**

Detyrat e përcaktuara nga ligji për secilën prej këtyre strukturave në këndvështrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta që ofrojnë për fëmijët apo referimit në shërbime specifike sipas nevojave të fëmijës janë pjesë e rëndësishme e Planit Social në Bashkinë Krujë.

⁷http://ëëë.amshc.gov.al/ëëb/doc/ligjore/Ligj_18-2017_Per_Te_Drejtat_dhe_Mbrojtjen_e_Femijes.pdf

Në çdo njësi administrative në varësi të Bashkisë, me përjashtim të Bashkive me më pak së 6 mijë banorë, ngrihet ***Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit***⁸, e cila siguron:

- a) identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë;
- b) vlerësimin fillestar të nevojave dhe të riskut për individët në nevojë;
- c) informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla;
- ç) hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes;
- d) bashkërendimin e mbështetjes për individët dhe familjet në nevojë, dhe referimin tek shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal dhe qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm;
- dh) përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit;
- e) mbikëqyrjen në vazhdim të ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimin mbi përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar.
- ë) hedhjen e të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, në Regjistrin Elektronik Kombëtar sipas përcaktimit të nenit 29, pika 2 të ligjit 121/2016.

Për të realizuar funksionet e përcaktuara Njësia për Vlerësimin dhe Referimin e Rasteve, duhet të ketë të paktën:

- a) një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6000 deri në 10 000 banorë;
- b) një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3000 fëmijë⁹;
- c) një administrator shoqëror¹⁰;

2. GJENDJA EGZISTUESE E STRUKTURAVE TË NJËSIVE VENDORE, SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR DHE INDIVIDËVE/GRUPEVE NË NEVOJË

Kjo pjesë e Raportit u hartua në përputhje me të dhënat e mbledhura nga grupi lokal dhe intervistat e kryera me qëllim identifikimin e:

- ✓ Strukturave përgjegjëse në nivelin e Bashkisë dhe njësive administrative, rolet, përgjegjësitë dhe kapacitetet aktuale;
- ✓ Individët/grupet në nevojë për shërbime dhe madhësinë e tyre;
- ✓ Shërbimet egzistuese të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë;

⁸ Nenet 36 dhe 37 të ligjit 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"

⁹ Kjo në përputhje me Ligjin "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"

¹⁰ Detyra sipas Ligjit "Për ndihmën ekonomike"

2.1 Vështrim i përgjithshëm

Bashkia Krujë është e organizuar në **6 njësi administrative**: Krujë, Fushë-Krujë, Thumanë, Nikël, Bubq dhe Cudhi dhe përfshin në territorin e saj **83,902 banorë**¹¹ me një shpërndarje 29,045 individë banojnë në **zonën urbane (35% e popullsisë) dhe** 54,857 individë banojnë në **zonën rurale (65% e popullsisë)**. Dendësia e popullsisë së Krujës është 240 banorë/ km².

Janë **23,369 familje** në territorin e Bashkisë Krujë nga të cilat:

- familje me një prind, 133 familje (0,5%)
- familje me fëmijë 0-6 vjeç; 160 familje (0,7%)
- familje që kanë në përbërje fëmijë me aftësi të kufizuara 252 familje (1,1%)
- familje më të moshuar të vetmuar-kryefamiljarë 25 familje (0,1%)

Tabela 1. Numri i banorëve dhe familjeve në Bashkinë Krujë (rregjistri i gjendjes civile)

Njesi administrative	Kruje	Fushe-Kruje	Thumane	Nikel	Bubq	Cudhi	Totali
Nr. Banorve	16,170	27,641	17,081	11,157	8,925	2,928	83,902
Nr. familje	5,209	8,030	4,759	3,087	2,595	972	24,652

Sipas Censusit të vitit 2011 në Bashkinë Krujë janë rregjistruar 59,814 banorë (pra 22,042 banorë më pak se sa numri që rezulton në rregjistrin e gjendjes civile). **Numri i fëmijëve të grup moshës 0-14 vjeç sipas censusit rezulton 14,093**, ndërkohë që numri i personave në moshë mbi 65 vjeç rezulton 5,637 individë. 51,4% e popullsisë janë meshkuj dhe 48,6% janë femra.

Tabela 2. Popullsia banuese sipas gjinisë, grupmoshës sipas njësisë administrative (INSTAT, Census 2011)

Bashkia/ NJA	GJINIA DHE GRUPMOSHA											
	Gjithsej				Meshkuj				Femra			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+

¹¹Të dhëna të vitit 2018, burimi Bashkia Krujë, gjendja civile

Gjithsej	59,814	14,093	40,084	5,637	30,743	7,505	20,567	2,671	29,071	6,588	19,517	2,966
Kruje	11,721	2,334	8,057	1,330	6,027	1,252	4,114	661	5,694	1,082	3,943	669
Fushe-Kruje	18,477	4,504	12,483	1,490	9,571	2,391	6,505	675	8,906	2,113	5,978	815
Thumane	12,335	2,955	8,184	1,196	6,282	1,596	4,127	559	6,053	1,359	4,057	637
Nikel	9,518	2,570	6,190	758	4,882	1,351	3,157	374	4,636	1,219	3,033	384
Bubq	5,951	1,250	4,008	693	3,010	658	2,033	319	2,941	592	1,975	374
Cudhi	1,812	480	1,162	170	971	257	631	83	841	223	531	87

Sipas të dhënave të Bashkisë në këtë territor banojnë **140 familje rome** (0,6 % e familjeve janë rome) dhe **166 familje Egjiptiane** (0,7 % e familjeve janë egjiptiane). Popullsia rome dhe egjiptiane është e përqëndruar kryesisht në Njesinë Administrative Fushë-Krujë.

Gjatë vitit 2022 janë regjistruar **125 divorce**.

2. 2. Të dhëna mbi organizimin dhe kapacitetet e stafit të Bashkisë

Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashki është **Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social**. Kjo drejtori ka në përbërje të saj Drejtorin dhe 5 specialistë: (1) Specialist i PAK; (2) Specialist i NE; (3) Specialist i Invalidit të punës; (4) Specialist Koordinimi për Dhunen në Marrëdhëniet Familjare; (5) Specialist për mbrojtjen e fëmijëve dhe Barazine gjinore.

Sipas Rregullores **kjo Drejtori ka si mision:**

3. Të evidentojë grupet në nevojë brenda territorit të bashkisë dhe të krijojë, brenda kuadrit ligjor, kushtet e favorshme për t'iu ofruar ndihmën e nevojshme ekonomike dhe shërbimin e duhur social familjeve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuar;
4. Të përgatisë çdo fund muaji projektvendimin përkatës për përfituesit e ndihmës ekonomike dhe pagesat e paaftësisë me listat bashkangjitur, të cilat përgatiten në katër kopje dhe dërgohen në Këshillin Bashkiak për miratim;

5. Të hartojë programe veprimi afatmesëm dhe afatgjatë, në zbatim të strategjive kombëtare dhe vendore, për zbutjen e varfërisë, integrimin e pakicave, implementimin e projekteve publike etj;
6. Të miratojë listat e përfituesve të ndihmës ekonomike dhe pagesat e paaftësisë;
7. Të bashkëpunojë me Drejtorinë e Financës për hartimin e dokumentacionit për dhënien e ndihmës ekonomike dhe pagesat e paaftësisë.

Detyrat e specialistëve të PAK dhe ndihmës ekonomike¹² duke ju referuar përshkrimin të tyre të punës lidhen drejtpërdrejtë me:

- ✓ proceset e aplikimit për përfitimin nga pagesat cash (NE dhe PAK),
- ✓ administrim dokumentacioni,
- ✓ ndërveprim me institucione të tjera që veprojnë në këtë fushë sipas legjislacionit në fuqi,
- ✓ verifikime social-ekonomike të familjeve përfituese të NE.
- ✓ vlerësimin e nevojave të individëve apo familjeve që kërkojnë të marrin shërbime shoqërore në përputhje me prioritetet e bashkisë dhe grumbullojë informacione për rrjetin e shërbimeve publike e private që veprojnë në territorin e bashkisë, si dhe ndihmojë aplikantët në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- ✓ ofrimin e konsulencës për legjislacionin dhe procedurat që duhet të ndjekin qytetarët në zgjidhjen e problemeve të tyre, gjithashtu të sqarojë pretenduesit për ligjin, të drejtat dhe detyrimet që duhet të plotësojnë për t'u përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike;

Detyrat e specialistit të koordinimit:

- ✓ Koordinon punën e Bashkisë me Njësitë Administrative;
- ✓ Pranon dokumentacionin dhe shpërndan informacionet e firmosura me Njësitë Administrative brenda muajit;
- ✓ Siguron që të bëhet brenda afatit ligjor mbledhja e dokumentacionit që mbulohen nga kjo Drejtori;
- ✓ Merr dhe shpërndan informacion nga Njësitë administrative;

Sipas Rregullores, **Specialisti për mbrojtjen e fëmijëve dhe barazinë gjinore** ka këto detyra:

1. Për mbrojtjen e fëmijës ka për detyrë¹³:

¹² Këto detyra janë të njëjta si për specialistin e NE dhe PAK në Drejtori, ashtu dhe në nivelin e njësive administrative

¹³ Këto detyra janë të njëjta si për PMF në drejtori ashtu dhe në njësitë administrative ku ka PMF

- ✓ Të identifikojë në mënyrë proaktive rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familjen e fëmijës në rrezik, komunikimit me profesionistët nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët;
- ✓ Të bëjë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje;
- ✓ Të kërkojë mbledhjen e grupit teknik ndërsektorial dhe të hartojë Planin Individual të Mbrojtjes, pjesë e të cilit është edhe propozimi për marrjen e masave të mbrojtjes;
- ✓ Të informojë drejtuesin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës dhe t'i propozojë drejtorit të strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore marrjen e masave të mbrojtjes mbi bazën e Planit Individual të Mbrojtjes, si dhe të koordinojë ndërhyrjet e veprimet që përcaktohen në plan;
- ✓ Të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacion për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel vendor e kombëtar, si dhe me shoqërinë civile, duke ruajtur të dhënat personale të fëmijës;
- ✓ Të monitorojë mbarëvajtjen e zbatimit të masës së mbrojtjes, progresin e zhvillimit të fëmijës, për të cilin është vendosur masa e mbrojtjes.
- ✓ Të marrë pjesë në proceset gjyqësore, në të cilat shqyrtohen masat e mbrojtjes të propozuara në planet individuale të mbrojtjes së fëmijës, për të cilët ai është menaxher rasti;
- ✓ T'i drejtohet prokurorit për heqjen e përgjegjësisë prindërore, duke e vënë atë në dijeni për prindërit që tregojnë pakujdesi të rëndë në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ose kur, me veprimet e tyre, prindërit ndikojnë në mënyrë të dëmshme në edukimin dhe zhvillimin e fëmijës.
- ✓ Të ndihmojë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në hartimin dhe dërgimin e ankesave pranë Avokatit të Popullit apo autoriteteve të tjera përgjegjëse.

2. Për barazinë gjinore

- ✓ Evidentimin e rasteve të grave të dhunuara.
- ✓ Ofrimin e suportit psikosocial grave të dhunuara.
- ✓ Ofrimi i konsulencës psiko sociale për gratë e dhunuara.
- ✓ Ndërmjetëson për rehabilitimin e tyre si në qendra ditore, rezidenciale.
- ✓ Plotëson database-n elektronik.
- ✓ Organizon aktivitete ndërmjetësimi me tema të ndryshme sociale.

Në nivelin e njësive administrative:

- ✓ Njësia administrative Krujë nuk është e veçuar nga Drejtoria e ndihmës ekonomike dhe shërbimit social. Bashkia Krujë përbëhet nga 5 Njësi Administrative të cilat janë në varësi të Drejtorisë së Shërbimit Social.
- ✓ Me përjashtim të njësisë administrative Cudhi ku ka vetëm një specialist të zyrës së shërbimit social, në njësitë e tjera administrative ka një punonjës të dedikuar për mbrojtjen e fëmijës dhe barazinë gjinore, si dhe nga 2-3 administratorë të NE dhe PAK.
- ✓ Përshkrimi i detyrave të tyre është i njëjtë me përshkrimet e punës së dhënë për specialistët respektiv në Drejtorinë e ndihmës Ekonomike dhe shërbimit Social.

Tabela 3: Burimet njerëzore në njësitë administrative të Bashkisë Krujë

Nr	Njësia administrative	Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit	Numër personeli punonjës social	Numër punonjësi mbrojtjes së fëmijëve dhe barazi gjinore	Numër punonjës administratorë shoqëror
1	Krujë	JO	1	1	3
2	Fushë-Krujë	Zyrë / 1 përgjegjës i zyrës	1	1	3
3	Thumanë	1 përgjegjës zyre	1	1	3
4	Nikël	1 përgjegjës zyre	1	1	2
5	Bubq	JO	0	1	2
6	Cudhi	1 përgjegjës zyre	0	0	1

2.3. Të dhëna mbi individët/grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror

2.3.1 Personat me aftësi të kufizuar

Sipas të dhënave të mbledhura nga Bashkia Krujë dhe të paraqitura në tabelën në vijim, rezultojnë **1,025 persona me aftësi të kufizuara** fizike, mendore dhe me probleme shikimi, si dhe **1,592 invalidë pune**.

Brenda aftësisë së kufizuar **grupi më i madh është ai i personave me probleme të shëndetit mendor (1025 persona)**, të cilët në numër më të lartë jetojnë në njësitë administrative **Krujë, Fushë-Krujë dhe Thumanë**. Personat me **statusin e para-tetraplegjikut janë 127** dhe në numër më të lartë janë në njësitë administrative **Krujë, Fushë Krujë dhe Thumanë**.

Tabela 4: Personat me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative

Nr	Persona me aftësi të kufizuara	Krujë	Fushë-Krujë	Thumanë	Nikël	Bubq	Cudhi	Totali
1	Nr. i personave me A.K. Fizike dhe mendor	193	352	228	90	90	72	1,025
2	Nr. i personave me Para-Tetraplegji	25	28	33	16	16	9	127
3	Nr. i personave të verbër	75	78	60	49	49	14	325
4	Invalidë pune	575	446	280	129	124	38	1,592
	TOTALI	868	904	601	284	279	133	3,069

2.3. 2 Familje përfituese të ndihmës ekonomike

Në Bashkinë Krujë **531 familje përfitojnë ndihmën ekonomike ose 2%** e familjeve të Bashkisë Krujë jetojnë përmes ndihmës ekonomike. **927 individë** të këtyre familjeve **janë fëmijë** të grupmoshës 0-18 vjeç. Njësitë administrative me numrin më të lartë të familjeve në ndihmë ekonomike janë Fushë-Krujë, Cudhi, Thumane.Trajtojmë dhe me ndihmë ekonomike me fondin 6% 34 familje.

Tabela 5: Familje në ndihmë ekonomike (viti 2022)

Nr	Familje me ndihmë ekonomike	Krujë	Fushë-Krujë	Thumanë	Nikël	Bubq	Cudhi	Totali
1	<i>Nr. i familjeve përfituese të ndihës ekonomike</i>	30	181	109	88	17	106	531
2	<i>Nr. i fëmijëve në familjet përfituese të ndihmës ekonomike6%</i>	13	12	4	0	3	2	34

2.3.3 Punëkërkues të papunë

Në zyrën e punës rezultojnë të regjistruar si **punëkërkues të papunë 982 individë**. Ajo që vihet re është që 53% e punëkërkuesve të papunë i përkasin grupmoshës 45-65 vjeç. Specifikisht:

Tabela 6: Punëkërkues të papunë

Mosha	Deri në 19 vjeç	20-24 vjeç	25-29 vjeç	30-34 vjeç	35-39 vjeç	40-44 vjeç	45-50 vjeç	Mbi 50 vjeç	Totali
Numri i punëkërkuesve	50	63	82	74	105	121	129	365	989

2.3.4 Fëmijët

Nr.	TREGUESIT	2022
1	Numri total i fëmijëve të lënë pa kujdes prindëror (gjatë vitit)	8
2	Numri total i fëmijëve në kujdes rezidencial (në fund të vitit)	4
3	Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kujdes rezidencial (në fund të vitit)	1
4	Numri dhe % e fëmijëve deri në 18 vjeç të identifikuar me probleme nga përdorimi i drogës ;	0
5	Numri i fëmijëve deri në 18 vjeç që trajtohen për problemet e alkoolit ;	0
6	Numri i rasteve të fëmijëve të: - Arrestuar; - ndaluar; - Dënuar;	Për vitin 2022 kane qenë 1fëmijë të arrestuar dhe 4 fëmijë të ndaluar apo shoqëruar. Ndersa për periudhën nentor dhjetor 2022 ka pasur vetem 1 fëmijë të arrestuar dhe 4 fëmijë të shoqëruar .
9	Numri i rasteve të identifikuar për fëmijë të shfrytëzuar për lypje, punë, neglizhim nga prindi/kujdestari	Janë identifikuar 10 raste të fëmijëve në situatë lypje .

10	Zona/zonat ku janë identifikuar rastet e shfrytëzimit të fëmijëve për lypje	Kryesisht në Qendër Fushë-Krujë
11	Numri i rasteve të fëmijëve viktimë të dhunës në familje të pajisur me urdhër të menjëhershëm mbrojtje/urdhër mbrojtje.	20
12	Numri i fëmijëve në familjet përfituese të ndihmës ekonomike, për secilën njësi administrative ¹⁴ .	989 fëmijë
13	Numri i fëmijëve të vendosur në familje kujdestare: - me Vendim Gjykatë - pa Vendim Gjykatë	4 fëmijë me Vendim Gjykatë
14	Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara	267 fëmijë: ✓ 66 fëmijë të grupmoshës 0-6 vjeç ✓ 142 fëmijë të grupmoshës 6-15 vjeç ✓ 59 fëmijë të grupmoshës 15-18 vjeç

2.3. 5. Viktima të dhunës në familje

Sipas të dhënave të raportuara nga Bashkia Krujë gjatë **vitit 2022 janë lëshuar urdhëra mbrojtje në 40 raste** dhe nga keto 40 raste në total, specifikisht 20 raste viktimë të dhunës në familje që kanë qenë gra janë trajtuar me pagesë në sistemin e ndihmës ekonomike dhe 4 raste viktimë të dhunës të pajisur me urdhëra mbrojtje kanë qenë burra.

2.3.6. Të moshuarit

Janë rreth 100 të moshuar që kanë kërkuar shërbim komunitar.

4.3.7. Familje të pastreha

Janë 180 familje që kanë paraqitur pranë Bashkisë nevojën e tyre për strehim. Sipas të dhënave të Bashkisë keto familje janë ende në pritje të një përgjigjeje. Ndërkohë asnjë prej familjeve nuk ka përfituar bonus qeraje apo banesë sociale.

¹⁴ shih tabelën 4: familje në ndihmë ekonomike;

Tabela 7. Përmbledhtazi individë dhe grupe në nevojë

Nr.	Individë/grupe në nevojë	Madhësia e grupit
1	Persona me aftësi të kufizuara	2,919 individë (PAK dhe invalidë pune)
2	Përfitues të ndihmës ekonomike	531 familje
3	Punëkërkues të papunë	989 individë
4	Viktima të dhunës në familje	40 individë
5	Të pastrehë	180 familje
6	Të moshuar në nevojë për shërbime	100 individë
7	Raste divorci	30 raste
8	Fëmijë të akomoduar në shërbim rezidencial	8 fëmijë
9	Fëmijë me aftësi të kufizuar në shërbim rezidencial	2 fëmijë
10	Fëmijë të shfrytëzuar për lypje	10 fëmijë
11	Fëmijë në familje përfitues të ndihmës ekonomike	989 fëmijë
12	Fëmijë të vendosur në shërbimin e familjes kujdestare	8 fëmijë
13	Fëmijë me aftësi të kufizuara	267 fëmijë
14	Fëmijë të arrestuar/ndaluar/dënuar	12 fëmijë

2.4. Të dhëna mbi shërbimet egzistuese të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë

2.4.1 Qendra sociale

Në territorin e Bashkisë Krujë janë ngritur dhe funksionojnë 5 Qendra Ditore dhe 1 Qendër rezidenciale.

✓ **Qendrat ditore:**

- 5 qendra janë ngritur nga ofrues jopublik

- 1 qendër e financuar nga bashkia
- në qendra përfitojnë shërbime gjithsej 542 individë dhe 54 familje

✓ **Qendra Rezidenciale:**

- 1 qendër e ngritur nga ofrues jopublik
- 57 fëmijë pa kujdes prindëror marrin shërbim në qendër.

Tabela 8: Qendra Ditore në Bashkinë Krujë

Nr.	Emri i Organizatës që ofron shërbimin	Grupi/et e përdoruesve të shërbimit dhe numri i tyre	Përshkruaj shërbimin	Numri mesatar i orëve të kujdesit për ditë	Ofruesi i shërbimit (qeveria/OJQ/sector privat)	Numri mesatar i stafit të paguar (specialistë dhe ndihmës)	Kostot operative vjetore	Burimi i financimit nga qeveria qendrore/pusheti vendor/të tjera
1	Porta Roma (Fushë-Krujë)	250 fëmijë jashtë kujdesit prindëror. Fëmijë me AK. Viktima të dhunës. Individë në nevojë	Regjistrim civil për komunitetin rom. Statistikë për komunitetin rom dhe egjiptian. Shërbim psikosocial. Shërbime punesimi.	6	OJQ	4		OJQ
2	Fondacioni Bashkësia e Jezusit	30 familje me individ në nevojë	Paketa ushqimore	2	Kisha	8	234,000	Kisha dhe donatorë të ndryshëm
3	Jetë në Zhvillim (Arramenas Fushë-Krujë)	35 Persona me afësi të kufizuar nga mosha 16 deri në 35 vjec	Terapi kopshtarie. Rrobaqëpsi. Terapi okupacionale. Aftësi për jetën në lëvizshmëri.	8	OJQ	11	718,985	Caritas Albania
4	Qendra ditore për të moshuar (Fushë-Krujë)	155 të moshuar	Kafe, çaj, lojra të ndryshme tavolinë, kujdes	6	Bashkia	4	35,000	Bashkia

			shëndetësor;					
5	Fondacioni SOS	60 fëmijë dhe 24 familje	Kurse arsimi. Kujdes shëndetësor. Shërbim ligjor dhe ekonomik.	6	OJF	5	150 euro	OJF
6	Qendra Komunitare Krujë	12 fëmijë	Shërbim psiko-terapeutik Fizioterapi Ergoterapi	3	OJF	3		Bashkia

Tabela 9: Qendra rezidenciale në Bashkinë Krujë

Emri i Organizatës që ofron shërbimin	Grupi/et e përdoruesve të shërbimit dhe numri i tyre	Përshkruaj shërbimin	Numri mesatar i orëve të kujdesit për ditë	Ofruesi i shërbimit (qeveria/OJQ/sekt or privat)	Numri mesatar i stafit të paguar (specialistë dhe ndihmës)	Kostot operative e vjetore	Burimi i financimit nga qeveria qendrore/ pushteti vendor/të tjera
BETANIA (Bubq)	57 fëmijë pa kujdes prindëror	Rezidencial	24 orë	OJQ	12 punonjës	500,000	Itali

2.4.2 Shërbimi në kopshte dhe çerdhe

- ✓ Të dhënat nga Bashkia Krujë, tregojnë se në territorin e Bashkisë janë **35 Kopshte ku marrin shërbim 1515 fëmijë. Nuk zbatohen lehtësira financiare për familjet në nevojë** që kanë fëmijë të moshës së kopshtit.
- ✓ Në territorin e Bashkisë janë **vetëm 2 çerdhe ku marrin shërbim 41 fëmijë**. Të dy çerdhet ndodhen në qytetin e Krujës. **Zbatohen lehtësira financiare për familjet në nevojë** që kanë fëmijë të moshës së çerddes.

Tabela 10. Shpërndarja e kopshteve dhe çerdheve në territorin e Bashkisë Krujë

Nr	Njësia administrative	Kopshte	Çerdhe
1	Krujë	10/ 313 fëmijë	2/ 41 fëmijë
2	Fushë-Krujë	6/ 622 fëmijë	0
3	Thumanë	5/ 239 fëmijë	0
4	Nikël	5/209 fëmijë	0
5	Cudhi	1/ 24 fëmijë	0
6	Bubq	5/108 fëmijë	0
	Totali	35 kopshte/ 1515 fëmijë	2 çerdhe/ 41 fëmijë

2.4.3 Shërbimi shëndetësor

Në territorin e Bashkisë janë 6 qendra shëndetësore të shpërndara në njësi administrative. Një qendër shëndetësore/njësi administrative.

2.4.4 Shkollat

- ✓ Në **31 shkolla të ciklit 9 vjeçar** në Bashkinë Krujë **mësojnë 6,148 fëmijë**.
- ✓ Në **6 shkolla të mesme** në Bashkinë Krujë mësojnë **2.864 fëmijë**.
- ✓ **Nuk ka shkollë profesionale**.
- ✓ **5 psikolog u shërbejnë 9.012 fëmijëve** të moshës shkollore ose **1 psikolog/1802 fëmijë**.
- ✓ Sipas të dhënave nga **Zyra Arsimore Krujë** ka **shumë pak raste të braktisjes së shkollës, kryesisht me komunitetin rom ne zonën e Njesisë Administrative Fushë-Krujë**.

3. VLERËSIMI I NEVOJAVE

3. 1. Nevojat për organizimin dhe strukturat e njësisë vendore

3.1.1 Organizimi në Bashki

Siç u përshkrua në pikën 2.2, Drejtoria e ndihmës ekonomike dhe shërbimit social përbëhet nga **drejtori dhe 5 specialist**. Duke vlerësuar rolet dhe përgjegjësitë e drejtorisë, ashtu dhe të specialistëve konstatojmë se:

- ***Drejtoria ka marrë edhe role dhe funksione që më së shumti janë role të Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rasteve për Njësinë Administrative Krujë.*** Drejtoria ka rol koordinues, monitorues, mbështetës për nivelin e njësive administrative dhe mbi të gjitha rol planifikues për shërbimet e kujdesit shoqëror, monitorues për shërbimet etj¹⁵.
- ***Në nivelin e Bashkisë egziston Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, jo thjesht Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës.*** Rolet dhe funksionet e kësaj njësie janë në përputhje me parashikimet në Ligjin "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve".
- ***Në strukturë egziston pozicioni i koordinatorit vendor për barazinë gjinore dhe dhunën në familje,*** detyrim ky nga Ligji për masat kundër dhunës në familje.
- ***Numri i personelit është në përputhje me nevojat për të përballuar detyrat e menaxhimit, administrimit, planifikimit dhe drejtimit në tre fusha: ndihmë ekonomike, aftësi e kufizuar, shërbime të kujdesit shoqëror.***

Rekomandim 1:

- ✓ Shtimi në strukturë i ***Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rasteve për cdo Njësi Administrative dhe për Bashkinë Krujë.***

Rekomandim 2:

- ✓ ***Rishikim i roleve dhe funksioneve të Drejtorisë në Rregulloren e Bashkisë.***

3.1.2 Niveli i njësisë administrative

Duke analizuar përgjegjësitë dhe detyrat që ka përcaktuar rregullorja e Bashkisë për administratorët e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë dhe vlerësuar numrin e individëve dhe familjeve në nevojë për të cilët ata punojnë, pa përfshirë individë të tjerë në nevojë për shërbime për të cilët të dhënat janë në nivel Bashkie dhe jo njësie administrative, rezulton ngarkesa e punës së tyre si në tabelën vijuese.

¹⁵ shih në Raport pika 1.3. Rolet dhe funksionet e Bashkisë në ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror/ struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror

Tabela 11: Ngarkesa e punës së administratorit shoqëror dhe paaftësisë në njësitë administrative

Nr	Grupet në nevojë sipas njësive administrative	Krujë	Fushë-Krujë	Thumanë	Nikël	Bubq	Cudhi	Totali
1	<i>Nr. i personave me A.K. Fizike dhe mendore</i>	193	352	228	90	90	72	1,025
2	<i>Nr. i personave me Para-Tetraplegji</i>	25	28	33	16	16	9	127
3	<i>Nr. i personave të verbër</i>	75	78	60	49	49	14	325
4	<i>Invalidë pune</i>	575	446	280	129	124	38	1,592
5	<i>Familje në ndihmë ekonomike</i>	30	181	109	88	17	106	531
6	TOTALI	898indivi dë dhe 30 familje	1085indi vidë dhe 181 familje	710indivi dë dhe 109 familje	372indivi dë dhe 88 familje	296indivi dë dhe 17 familje	239indivi dë dhe 106 familje	3600indivi dë dhe 531familje
7	<i>Numri i administratorëve të ndihmës ekonomike dhe paaftësisë</i>	5	5	4	3	3	1	21
8	<i>Numri i fëmijëve në familje më ndihmë ekonomike¹⁶</i>	113	281	178	137	9	170	888
	<i>Numri i punonjësve të mbrojtjes së fëmijës</i>	1	1	1	1	1	0	5
9	<i>Popullsia</i>	16,170	27,641	17,081	11,157	8,925	2,928	83,902

Ngritja e *Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rasteve është detyrim që rrjedh nga ligji "për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"* dhe në përputhje dhe me *Ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës* kjo Njësi duhet të përbëhet nga:

- d) një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6000 deri në 10 000 banorë;
- e) një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3000 fëmijë;
- f) administrator shoqëror;

Bazuar në këto kritere ligjore duhet:

¹⁶ Po marrim si referim këtë numër, por në fakt punonjësi i mbrojtjes së fëmijës ka detyra që lidhen me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të të gjithë fëmijëve

1. Njësia administrative Krujë të ketë Nj.V.N.R.R:

- a) punonjës social - 1 deri në 2.
- b) punonjës i mbrojtjes së fëmijës - 1
- c) administrator shoqëror- me ngarkesën aktuale ka 1 administrator shoqëror për 290 individë (sepse gjithsej janë 3 administratorë shoqëror)

Rekomandim 3:

- ✓ Shtimi me një punonjës social ose rishpërndarje: 1 administrator shoqëror dhe 1 punonjës social.

2. Njësia administrative Fushë-Krujë duhet të ketë Nj.V.N.R.R:

- a) punonjës social - duhet të ketë 2 deri në 3 punonjës social/ aktualisht ka 2 punonjës social
- b) punonjës i mbrojtjes së fëmijës - 1
- c) administrator shoqëror - me ngarkesën aktuale ka 1 administrator shoqëror për 290 individë (sepse janë gjithsej 3 administratorë shoqëror).

Rekomandim 4:

- ✓ Shtimi me një punonjës social në vitin e dytë të planit.

3. Njësia administrative Thumanë duhet të ketë Nj.V.N.R.R:

- a) punonjës social - duhet të ketë 1 deri në 2 punonjës social/ aktualisht ka 1 punonjës social
- b) punonjës i mbrojtjes së fëmijës - 1
- c) administrator shoqëror - me ngarkesën aktuale ka 1 administrator shoqëror për 290 individë (sepse janë gjithsej 3 administratorë shoqëror).

Rekomandim 5:

- ✓ Shtimi me një punonjës social ose rishpërndarje: 1 administrator shoqëror dhe 1 punonjës social.

4. Njësia administrative Nikël duhet të ketë Nj.V.N.R.R:

- a) punonjës social - 1 / aktualisht nuk ka asnjë.
- b) punonjës i mbrojtjes së fëmijës - 1
- c) administrator shoqëror- me ngarkesën aktuale ka 1 administrator shoqëror për 200 individë (sepse gjithsej janë 2 administratorë shoqëror)

Rekomandim 6:

- ✓ Shtimi me një punonjës social.

5. Njësia administrative Bubq duhet të ketë Nj.V.N.R.R:

- a) punonjës social - 1 / aktualisht nuk ka asnjë.
- b) punonjës i mbrojtjes së fëmijës - 1
- c) administrator shoqëror- me ngarkesën aktuale ka 1 administrator shoqëror për 180 individë (sepse gjithsej janë 2 administratorë shoqëror)

Rekomandim 7:

- ✓ Shtimi me një punonjës social.

6. Njësia administrative Cudhi nuk duhet të ketë Nj.V.N.R.R pasi ka më pak se 6,000 banorë:

- d) punonjës social - 0 / aktualisht nuk ka asnjë.
- e) punonjës i mbrojtjes së fëmijës - 0
- f) administrator shoqëror- me ngarkesën aktuale ka 1 administrator shoqëror për 200 individë (sepse gjithsej janë 1 administratorë shoqëror).

Rregullorja e Bashkisë duhet ti përgjigjet realitetit të ri ligjor duke u rishikuar dhe përfshirë në nivelin e njësisë administrative Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit me këto detyra që i shtohen detyrave në kuadrin e pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar:

- f) identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë;
- g) vlerësimin fillestar të nevojave dhe të riskut për individët në nevojë;
- h) informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla;
- ç) hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes;
- i) bashkërendimin e mbështetjes për individët dhe familjet në nevojë, dhe referimin tek shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal dhe qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm;
- dh) përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit;
- j) mbikëqyrjen në vazhdim të ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimin mbi përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar.
- ë) hedhjen e të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, në Regjistrin Elektronik Kombëtar sipas përcaktimit të nenit 29, pika 2 të ligjit 121/2016.

Rekomandim 8:

- ✓ Rishikimi i detyrave funksionale të stafit duke parashikuar detyrat e Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit në Njësinë Administrative.

Rekomandim 9:

- ✓ Parashikim në buxhet për shpenzime operative të stafit të njësisë administrative me qëllim menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve sociale.

3. 2. Nevojat për ngritjen e kapaciteteve të stafit

Në nivelin e strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror **në Bashki** identifikohen **këto nevoja për ngritje kapaciteti të stafit:**

- ✓ Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi;
- ✓ Hartimi i sistemeve për të mbështetur menaxhimin, implementimin, komunikimin dhe përgjegjësinë;
- ✓ Monitorimi & vlerësimi;
- ✓ Puna me shërbimin jopublik, krijim rrjeti komunikimi dhe bashkepunimi për ofrim shërbimesh dhe referime rastesh urgjente.
- ✓ Prokurimi i shërbimeve të kujdesit social;
- ✓ Buxhetimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror;

Në nivelin e njësive administrative vendosja e punonjësve social duhet të shoqërohet me trainime për:

- ✓ Teknika të menaxhimit të rasteve sociale,
- ✓ Njohuri mbi legjislacionin në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, aftësisë së kufizuar, dhunës me bazë gjinore etj.
- ✓ Trajnime të vazhdueshme me në fokus se si menaxhohet rasti nga fillimi deri në zgjidhjen e tij.

Rekomandim 10:

- ✓ Parashikimi dhe ofrimi i paketës trajnuese për stafet në nivelin e Bashkisë dhe të njësive administrative.

3. 3. Nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror

Për të vlerësuar nevojat për shërbime do të referohemi individëve dhe grupeve në nevojë të identifikuar në pikën 2.3 si dhe shërbimeve egzistuese në territorin e Bashkisë të identifikuar në pikën 2.4. Në vijim tabela pasqyron individët/grupet në nevojë, madhësinë e grupeve, nevojat për shërbime, si dhe egzistencën e shërbimeve aktualisht. Mbi këtë bazë do të orientohet planifikimi i shërbimeve që duhet të ngrihen në vijim dhe do të jenë pjesë e Planit Social të Bashkisë Krujë.

Nr.	Individë/grupe në nevojë për shërbime	Madhësia e grupit	Shërbimi i nevojshëm për të adresuar nevojat sipas shportës së shërbimeve	Egzistenca e shërbimit
1	<i>Persona me aftësi të kufizuara</i>	2,919 ¹⁷ individë: <i>a. 625 persona me</i>	a. ✓ shërbim shëndetësor	- Shërbim shëndetësor

¹⁷ Nga këta 252 janë fëmijë me aftësi të kufizuara

		probleme të shëndetit mendor/299 në zonë rurale b. 135 persona para dhe tetraplegjik/70 në zonë rurale c. 335 persona të verbër/180 në zonë rurale	✓ terapi zhvillimi ✓ terapi okupacionale b. ✓ shërbim shëndetësor ✓ fizioterapi ✓ shërbim në shtëpi c. ✓ shërbime rehabilitimi ✓ shërbim në shtëpi	- 1 qendër ditore për 35 persona me aftësi të kufizuara (5.6% e personave me probleme të shëndetit mendor marrin shërbim)
2	Përfitues të ndihmës ekonomike	531 familje/ 292 në zonë rurale	✓ shërbim në shtëpi (paketa ushqimore) ✓ programme riintegrimi në tregun e punës	✓ 3 shërbime por me kapacitet të limituar (Porta Romana, "Bashkësia e Jezusit" dhe Fondacioni SOS)
3	Punëkërkues të papunë	989 individë	✓ këshillim për punësim ✓ program nxitje punësimi	✓ zyra e punës ✓ jo
4	Viktima të dhunës në familje¹⁸	40 individë	✓ shërbimi i emergjencës orëshe 72 ✓ shërbim shëndetësor ✓ konsulencë ligjore ✓ shërbim psikologjik ✓ program punësimi	✓ jo
5	Familje të pastreha	180 familje	✓ bonus qeraja ✓ strehimi social	✓ jo
6	Të moshuar në nevojë për shërbime	100	✓ qendër ditore ✓ shërbim në shtëpi	✓ një qendër ditore në Fushë Krujë
7	Familje që kanë përfjetuar divorc	30	✓ shërbim psikologjik	✓ jo

¹⁸ Shifra është indikative, pasi raportohet që në realitet ka shumë më tepër raste dhune por që nuk raportohen tek institucionet

8	Fëmijë të akomoduar në shërbim rezidencial	8	✓ shërbim i kujdesit në familje kujdestare	✓ jo
9	Fëmijë me aftësi të kufizuara në shërbim rezidencial	2	✓ shërbim i kujdesit në familje kujdestare ✓ shërbim rehabilitues dhe zhvillues komunitar	✓ jo ✓ vetëm në Fushë Krujë
10	Fëmijë të shfrytëzuar për lypje	10	✓ shërbime në qendër ditore (ndjekje e shkollës, aktivitet riintegruar, fuqizim familje)	✓ 1 qendër ditore në Fushë Krujë
11	Fëmijë në familje përfituese të ndihmës ekonomike	989	✓ shërbime në qendër ditore (ndjekje e shkollës, aktivitet riintegruar, fuqizim familje) ✓ vendosja e kuotave për përfshirjen në kopshte dhe çerdhe për grupmoshat respektive	✓ 2 shërbime por me kapacitet të limituar
12	Fëmijë në familje kujdestare	8	✓ monitorim	✓ jo
13	Fëmijë me aftësi të kufizuara	267	✓ shërbime rehabilitimi dhe zhvillimi qendër ditore/shërbim në familje	✓ vetëm 1 qendër ditore në Fushë Krujë
14	Fëmijë të arrestuar/ndaluar/dënuar	12	✓ programe riintegrimi	✓ jo
15	Komuniteti rom dhe egjiptian)	140 familje rome dhe 166 familje egjiptiane	✓ programe fuqizimi	✓ 1 qendër ditore "Porta Romana, Fushë Krujë

Rekomandim 11: Ngritja dhe funksionimi i një qendre ditore per personat me PAK mbi 18 vjec.

- Ngritja dhe funksionimi i një qendre ditore për persona me AK në njësinë administrative Krujë për te ritur dhe familjen brenda qendrës dhe shërbim në shtëpi për raste të vlerësuara nga NjVNR në njësitë administrative përreth NjA Krujë. Qendra do të ofroj këto shërbime:

- ✓ Shërbim zhvillimi dhe reabilitimi për të rritur me aftësi të kufizuara, me probleme të shëndetit mendor dhe/ose fizik (terapi zhvillimi, okupacionale, reabilitim fizik).
- ✓ Shërbime në shtëpi për të rritur me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për terapi zhvillimi dhe distanca nga qendra multifunksionale i pengon në marrjen e shërbimit.
- ✓ Shërbim reabilitues për të rritur në konflikt me ligjin.
- ✓ Shërbim lëvizës në familje për të moshuarit në nevojë për shërbim.
- ✓ Programe këshillimi për prindërimin.
- ✓ Programe për menaxhimin e zemërimit për prindërit e dhunshëm.
- ✓ Këshillim psikologjik individual për të rritur në nevojë për mbrojtje
- ✓ Këshillim për punësimin.
- ✓ Programe për përdoruesit e drogave.
- ✓ Programe për personat me varësi nga alkooli.
- ✓ Për familjet ekstremisht të varfëra mbështetje me paketa ushqimore.

Rekomandim 12: Ngritja dhe funksionimi i nje qendre ditore per femije ne Njesine Administrative Fushe Kruje.

- Ngritja dhe funksionimi i qendrës ditore në njësinë administrative Fushë-Krujë që ofron shërbime për fëmijën dhe familjen brenda qendrës dhe shërbim në shtëpi për raste të vlerësuara nga NjVNR. Qendra do të ofroj këto shërbime:
 - ✓ Programe këshillimi për prindërimin
 - ✓ Programe për menaxhimin e zemërimit për prindërit e dhunshëm
 - ✓ Këshillim psikologjik individual për çdo fëmijë në nevojë për mbrojtje
 - ✓ Programi i trajnimit të familjes kujdestare (shërbim i kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror të përkohshëm)
 - ✓ Shërbim reabilitues për fëmijët në konflikt me ligjin
 - ✓ Këshillim për punësimin
 - ✓ Programe për përdoruesit e drogave
 - ✓ Programe për personat me varësi nga alkooli
 - ✓ Për familjet ekstremisht të varfëra mbështetje me paketa ushqimore.
- Qendra ditore për personat me aftësi të kufizuara në Fushë Krujë plotëson shërbimin aktual me shërbimin në shtëpi për fëmijë me aftësi të kufizuara që banojnë në zona përreth NjA Fushë Krujë që kanë nevojë për shërbime reabilituese.
- Vendosja e kuotave në kopshte dhe çerdhe për fëmijët e familjeve më në nevojë për të marrë shërbimin pa pagesë.
- Ndërveprim me shërbimet e punësimit për zhvillimin e programeve të nxitjes së punësimit. Programe integrimi në tregun e punës për pjestarët madhor të familjeve në ndihmë ekonomike duke ndjekur hapat vijues: Studim të tregut të punës në Bashkinë Krujë; Vlerësimi real i nevojave për punë; Vlerësimi i profileve të mundshme të

punësimit; Ofrimi i kurseve të formimit profesional sipas profilit të identifikuar nga studimi;

- Ngritja dhe funksionimi i shërbimit të kujdesit në familje kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror.
- Ngritja e shërbimit të emergjencës për fëmijë pa kujdes prindëror të përkohshëm në bashkëpunim me Qendrën "Betania".
- Ngritja e shërbimit të emergjencës 72 orëshe për viktimat e dhunës në familje, përfshirë këshillim ligjor e psikologjik.
- Trajtimi me prioritet për strehim i viktimave të dhunës në familje, personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve me ndihmë ekonomike.
- Qendra ditore për të moshuarit në Fushë Krujë plotëson shërbimin aktual me shërbimin në shtëpi për të moshuarit që banojnë në zona përreth NjA Fushë Krujë që kanë nevojë për shërbime rehabilituese.

PJESA E DYTË

PLANI SOCIAL I BASHKISË KRUJË

1. Vizioni, parimet dhe qëllimet

1.1 Vizioni

Bashkia Krujë synon të ndërtojë një sistem të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të bazuar në nevojat sociale të popullatës, në standartet dhe kuadrin ligjor për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe që në ofrimin e shërbimeve mban në qendër nevojat e individit me synim mbështetjen dhe fuqizimin e tij/saj për riintegrim të plotë në jetën ekonomike dhe sociale.

1.2 Parimet

Në ngritjen dhe funksionimin e sistemit të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror Bashkia Krujë do të udhëhiqet nga parimet më të rëndësishme të sanksionuara në legjislacionin kombëtar dhe specifikisht:

- ✓ Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara, etj.
- ✓ Grupe të veçanta, përfshirë fëmijët, duhen të jenë subjekt i mbrojtjes së veçantë, bazuar në nevojat dhe të drejtat e tyre.
- ✓ Krijimi i një mjedis të përshtatshëm që të mbështesë zhvillimin maksimal të individëve.
- ✓ Individët janë përgjegjës për jetën e tyre dhe çdo shërbim duhet të respektojë parimin e pavarësisë dhe autonomisë së tyre.
- ✓ Koordinimi i strukturave qendrore, qeverisjes rajonale dhe vendore, si dhe partnerë të tjerë në komunitet.
- ✓ Vendimarrja në nivel vendor udhëhiqet nga standartet kombëtare.

1.3 Qëllimet specifike

Katër janë qëllimet që pritet të përmbushen nga zbatimi i Planit Social të Bashkisë Krujë dhe specifikisht:

Qëllimi 1: Fuqizimi i strukturave dhe kapaciteteve të shërbimeve sociale të Bashkisë

Ky qëllim i përgjigjet realitetit të ri ligjor dhe konceptit të ri të ngritjes dhe funksionimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, ku Bashkia merr role e përgjegjësi në dy nivelet e organizimit:

në Bashki përmes strukturës përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe në njësinë administrative përmes Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.

Qëllimi do të përmbushet përmes:

1. Ristrukturimi dhe plotësimi i strukturave përgjegjëse në përputhje me legjislacionin. Ndryshimet prekin si organizimin aktual të strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashkinë Krujë, ashtu edhe njësitë administrative. Në njësitë administrative Krujë, Fushë-Krujë, Thumanë, Nikël, dhe Bubq do të ngrihen Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të përbëra nga punonjës social, punonjës i mbrojtjes së fëmijës dhe administrator shoqëror. Në njësinë Cudhi, për shkak të numrit të ulët të banorëve (nën 6.000 banorë) është parashikuar rishikim i detyrave funksionale për t'ju përgjigjur detyrimeve ligjore. Struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror do të marrë detyra funksionale në përputhje me detyrimet ligjore dhe në këtë strukturë ndër të tjera parashikohet funksioni i koordinatorit për zhvillimin ekonomik, që do të ketë në fokus veçanërisht lidhjes e skemës cash të ndihmës ekonomike me politikat lokale të nxitjes së punësimit.
2. Ngritja e kapaciteteve të stafëve në ushtrimin e detyrave funksionale dhe menaxhimin e rasteve sociale. Trainimet e parashikuara i përgjigjen nevojave të identifikuar për trainim në të dy nivelet e organizimit të bashkisë në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Qëllimi 2: Zhvillimi i qasjes ndërsektorale në menaxhimin e rasteve sociale

Mban në konsideratë faktin se Bashkia nuk është i vetmi aktor që ka detyrimin për adresimin e nevojave të grupeve vulnerabël, kjo në përputhje me legjislacionin, sikundër edhe është qasja e duhur për të menaxhuar rastet shpesh komplekse sociale. Përmbushja e këtij qëllimi mundësohet përmes një numri ndërhyrjesh si:

1. Ngritja dhe funksionimi i Grupit Ndërsektorial ad hoc, në nivel drejtuesish të institucioneve vendore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe Grupit Teknik Ndërsektorial.
2. Takime informuese me institucionet vendore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve mbi punën e NJMF dhe detyrimet ligjore e institucionale reciproke në mbrojtjen e fëmijëve.
3. Ngritja dhe funksionimi i Komitetit Drejtues Lokal në nivel drejtuesish të institucioneve vendore përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës, si dhe Ekipit Teknik Ndërdisciplinor për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.
4. Takime informuese me institucionet vendore përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave mbi detyrimet ligjore e institucionale reciproke në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.
5. Zhvillimi i aftësive organizative për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave të mbrojtjes së individëve dhe grupeve në nevojë, të dhëna që duhet të vijnë nga burime të

ndryshme brenda dhe jashtë strukturave të Bashkisë dhe janë një bazë e rëndësishme për planifikimin dhe rishikimin e planeve sociale lokale në vijim.

Qëllimi 3: Ngritja dhe funksionimi i rrjetit lokal të koordinuar të shërbimeve të kujdesit shoqëror

Ndërhyrjet për përmbushjen e këtij objekti janë parashikuar në pesë drejtime që plotësojnë njëra-tjetrën:

1. Parandalimi i rasteve të dhunës, abuzimit dhe neglizhimit, që do të mundësohen përmes fushatave të informimit mbi të drejtat e fëmijës dhe masat për mbrojtje, si dhe takimeve komunitare me qëllim informimin në lidhje me dhunën në familje dhe ndërgjegjësimin e komuniteteve lokale për ta parandaluar dhunën.

2. Krijimi i kushteve për identifikimin e rasteve të individëve në nevojë për mbrojtje dhe shërbime të kujdesit shoqëror. Synohet që përmes aktiviteteve të parashikuara stafet sociale dhe shërbimet të shkojnë atje ku janë individët në nevojë. Një nga arsyt pse numri i individëve në nevojë të identifikuar gjatë përgatitjes së këtij plani është më i ulët se sa realiteti i perceptuar nga aktorët lokal në kontakt me komunitetin është fakti që mungojnë aktualisht mekanizmat për ti identifikuar individët në nevojë në komunitet dhe jo vetëm kur ata i drejtohen institucioneve për mbështetje. Për ta mundësuar këtë në Plan parashikohet:

- a. Përgatitja e paketës me formularët e dokumentimit dhe raportimit të rasteve të individëve në nevojë për mbrojtje, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore.
- b. Numër i dedikuar për rastet e emergjencës për individët në nevojë.
- c. Trajnim i kryepaqve për identifikimin e rasteve të individëve në nevojë për shërbime, pasi ata janë në kontakt me komunitetin.
- d. Takime informuese të stafit të Nj.V.N.R me institucione lokale prej nga mund të referohen raste të individëve në nevojë për mbrojtje dhe shërbime.
- e. Afishimi dhe publikimi i numrit të dedikuar për informim, koordinim, referim të rasteve të individëve në nevojë.
- f. Përgatitja e seksionit mbi mbrojtjen sociale dhe shërbimet shoqërore si pjesë e faqes web të Bashkisë.

3. Rritja e efektivitetit në menaxhimin e rasteve të individëve në nevojë për mbrojtje dhe shërbime të kujdesit shoqëror, parashikon ndërhyrje në nivelin e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, e cila në përputhje me legjislacionin në fuqi ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë në menaxhimin e rasteve sociale dhe referimin tek shërbime të kujdesit shoqëror sipas nevojave të individit.

4. Ngritja dhe funksionimi i rrjetit lokal të koordinuar të shërbimeve të kujdesit shoqëror, që do të mundësohet nga ngritja dhe funksionimi gradual gjatë periudhës tre vjeçare të zbatimit të këtij Planit. Shërbimet e planifikuara janë:

- Ngritja dhe funksionimi i nje qendre ditore per personat me PAK mbi 18 vjec.
- Ngritja dhe funksionimi i Qendrës multifunktionale për fëmijën dhe familjen në njësinë administrative Fushe Krujë.
- Ngritja dhe funksionimi i shërbimit të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror në familje kujdestare.
- Ngritja dhe funksionimi i shërbimit të emergjencës për fëmijë pa kujdes prindëror të përkohshëm në bashkëpunim me Qendrën "Betania".
- Funksionimi i shërbimit të emergjencës 72 orë për viktimat e dhunës në familje.
- Qendër ditore për të moshuarit dhe shërbim në familje.
- Ngritja dhe funksionimi i qendrës multifunktionale në njësinë administrative Fushë-Krujë.
- Qendër ditore për të rriturit me aftësi të kufizuara në Bashkinë Krujë.

5. Ngritja dhe funksionimi i mekanizmave që mundësojnë përfshirjen e përfituesve të shërbimeve në vendimarrjet e Bashkisë. Përfshirja e grupeve vulnerabël në proceset e vendimarrjes është së pari domosdoshmëri për vetë zbatimin e Planit Social dhe rishikimin e tij duke mbajtur në konsideratë mendimin dhe vlerësimin e përfituesve të tij, së dyti është një mjet për të garantuar llogaridhënien e vendimarrësve lokal në lidhje me mbrojtjen sociale dhe shërbimet e kujdesit shoqëror. Plani parashikon konsultim të buxhetit dhe planit të veprimit vjetor të Bashkisë me fëmijët, gratë dhe grupe në nevojë.

Qëllimi 4: Mbrojtja dhe riintegrimi i familjeve në nevojë

Për përmbushjen e këtij qëllimi do të punohet përmes qasjes së mbështetjes me ndihmë ekonomike, por si një masë tranzitore e shoqëruar me një numër shërbimesh që fuqizojnë individët madhorë të familjeve në nevojë dhe i riintegrojnë në tregun e punës në sajë të bashkëpunimit me Shërbimin kombëtar të punësimit. Aktivitetet kryesore të parashikuara në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi janë:

1. Identifikimi i familjeve ekstremisht të varfra, përfituese dhe jopërfituese të ndihmës ekonomike.
2. Mbështetje emergjente për nevojat bazë të familjeve në nevojë.
3. Referimi tek këshillimi për punësim.
 - Ndërveprimi me Shërbimin Kombëtar të punësimit për zhvillimin e programeve të nxitjes së punësimit.

4. Alokimi i kuotës prej 5% në çerdhe dhe kopshte për fëmijët në nevojë për mbrojtje.
5. Trajtimi me bonus qeraje ose banesë sociale të familjeve të pastreha dhe në situatë të vështirë ekonomike.

2. Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi

2.1 Zbatimi

Ky Plan Veprimi u planifikua për të qenë njëherazi një mjet drejtimi për një periudhë katër vjeçare, si dhe një mjet i menaxhimit të përditshëm të angazhimeve të strukturave përgjegjëse me zbatimin e tij. Ky plan do të ndihmojë strukturat përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të tij që të fokusohen në përmbushjen e tyre dhe të sjellin rezultatet e dëshiruara.

Gjatë procesit të përgatitjes së këtij Plani stafi i Bashkisë u mbështet me kapacitetet e nevojshme që këtë proces në vijim ta kryejnë vetë. Edhe Plani i Veprimit Lokal është dizenuar në mënyrë të tillë që në fund të zbatimit katër vjeçar të këtij Plani Bashkia të kenë kapacitetin e nevojshëm për të vlerësuar dhe analizuar, sikurse dhe hartuar Planin e Veprimit vijues.

Plani është parashikuar të zbatohet për një periudhë katër vjeçare dhe për çdo aktivitetet është përcaktuar qartësisht koha e zbatimit duke mbajtur në konsideratë dy faktorë:

1. Prioriteti i ndërhyrjes, në përputhje me vlerësimin e kryer të nevojave.
2. Kostoja e çdo aktiviteti dhe shpejtësia e ngritjes së fondit social lokal.

Duke qenë që janë ende në proces aktet nënligjore që rregullojnë mekanizmin e financimit, ndërhyrjet me kostot më të larta, kryesisht ngritja e shërbimeve komunitare, janë parashikuar të ndodhin në vitin e dytë, të tretë dhe të katërt të planit, duke përdorur vitin e parë jo vetëm për ngritjen dhe përgatitjen e strukturave lokale, si dhe të kushteve për ngritjen e rrjetit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, por edhe për të ngritur fondin social lokal të Bashkisë Krujë me fonde kryesisht nga Bashkia, qeveria qendrore dhe donatorë.

Në plan është përcaktuar për çdo aktivitet njësi/stafi zbatues i aktivitetit specifik. Edhe pse zbatimi i planit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Bashkisë, partneriteti me organizata ofruese shërbimesh apo që kanë projekte për të ofruar shërbime në periudhën e zbatimit të këtij plani është pasqyruar në këtë Plan. Zgjerimi i këtij partneriteti me organizata/ofrues të tjerë do të mbetet detyrë e vazhdueshme e strukturës përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Krujë.

Plani do të jetë objekt rishikimi çdo vit veçanërisht në funksion të atyre aktiviteteve për të cilat duhet të mbahen në konsideratë zhvillimet afatshkurtra lokale dhe nevojat koherente të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.

2. 2. Monitorimi dhe vlerësimi

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit do të jetë verifikimi sesa efektiv ka qenë zbatimi i aktiviteteve, a janë përmbushur në mënyrë të sukseshme qëllimet specifike të planit dhe mbi të gjitha çfarë ndikimi ka pasur zbatimi tek individët në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.

Për efekt të monitorimit dhe vlerësimit për çdo aktivitet të Planit është parashikuar njësia/të përgjegjëse për monitorimin e çdo aktivitetit, ndërkohë që për çdo aktivitet është përcaktuar lista e treguesve që lehtësojnë procesin e monitorimit dhe vlerësimit. Procesi i monitorimit dhe vlerësimit duhet të kalojë përmes:

- a) Mbledhja e të dhënave;
- b) Analizimi i të dhënave;
- c) Raportimi;

Mbledhja e të dhënave dhe e informacionit të nevojshëm për matjen e treguesve të përcaktuar është një etapë thelbësore e procesit të monitorimit. Këto të dhëna do të përdoren për të vlerësuar nëse aktivitetet e planifikuara janë zbatuar në praktikë sipas specifikimeve përkatëse të Planit të Veprimit (në sasinë dhe cilësinë e parashikuar), sikurse të dhënat e mbledhura do të japin pamje të qartë mbi arritjet dhe problematikat që kanë dalë gjatë zbatimit të Planit.

Të dhënat e mbledhura dhe të analizuar do të jenë bazë e Raportit njëvjeçar. Raporti do të shërbejë gjithashtu edhe për të rishikuar ato elementë të Planit trevjeçar që marrin një fokus të ri për shkak të arritjeve dhe problematikave të identifikuara në periudhën një vjeçare.

Gjatë periudhës së zbatimit do të kryhen tre vlerësime të cilat do të influencojnë drejtpërdrejt riorganizimin dhe riformulimin e qëllimeve specifike dhe aktiviteteve për vitet pasuese:

- 3 vlerësime dhe Raporte Vjetore (fund i 2024, fund i 2025 dhe 2026). Këto raporte do shërbejnë vlerësuar realizimet dhe mosrealizimet, si dhe për të rishikuar Planin e Veprimit për vitin pasardhës.
- Vlerësimi dhe Raporti përfundimtar (fund i 2027). Ky raport do të shërbejë edhe për të përgatitur Planin pasardhës afatmesëm të Bashkisë.

Përgjatë fazës së përgatitjes së këtij Plani stafi i strukturës përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror u trainua edhe për komponentin e monitorimit dhe vlerësimit me qëllim që të ketë kapacitetin për ta zhvilluar këtë proces të rëndësishëm. Ndërkohë vetë përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror do të kenë zë në vlerësimin e tyre, pasi Plani përmban aktivitete që Bashkia të ngrejë mekanizma për të marrë mendimin e tyre në vendimarrje të rëndësishme, siç është edhe zbatimi dhe rishikimi i këtij Plani.

Bazuar në detyrimet ligjore, shumë prej aktiviteteve të përfshira në Plan Veprimi janë subjekt i monitorimit, kontrollit apo inspektimit nga institucione kombëtare si: Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektoriati Shëndetësor dhe i Mbrojtjes Sociale. Rezultatet e kontroleve, monitorimeve apo inspektimeve do të mbahen gjithashtu në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit të Planit nga struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror të Bashkisë.

PLANI SOCIAL BASHKIA KRUJË

2023-2027

QËLLIMI 1 – FUQIZIMI I STRUKTURAVE DHE KAPACITETEVE TË SHËRBIMEVE SOCIALE TË BASHKISË

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	PËRFITUESIT	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Objektivi specifik 1: Ristrukturimi dhe plotësimi i strukturave përgjegjëse në përputhje me legjislacionin							
Aktiviteti 1: Riorganizimi, miratimi i strukturës dhe përshkrimeve të punës së strukturës përgjegjëse të shërbimit social në Bashki¹⁹ <i>Rishikim i përshkrimit të punës për çdo pozicion dhe struktura :</i> ✓ Drejtori ✓ Punonjës social -1 ✓ punonjës social-koordinator i fuqizimit	Drejtoria e ndihmës ekonomike dhe shërbimit social Drejtoria juridike	Nëntor-dhjetor 2022	Struktura përgjegjëse e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore; Rregullorja e Bashkisë Krujë përmban përshkrim të ri pune për strukturën përgjegjëse dhe çdo specialisti sipas parashikimeve ligjore;	-Stafi i strukturës përgjegjëse të shërbimeve sociale të Bashkisë, që do të ketë role dhe funksione të shprehura qartë në rregullore dhe kontratën e tyre të punës. - Të gjithë individët në nevojë për shërbime që përfitojnë përmes rritjes së efikasitetit të strukturës të organizuar dhe funksione në përputhje me kriteret ligjore.	Bashkia Krujë	5.760.000	Sekretari i Përgjithshëm

¹⁹ Shih rekomandimi 1 dhe 2 faqe 30, Raporti i Vlerësimit të Nevojave

<i>ekonomik-1</i> ✓ Koordinator vendor për barazinë gjinore dhe dhunën në familje - 1 ✓ Njësia e mbrojtjes së fëmijës – 2							
Aktiviteti 2: Përgatitja dhe miratimi i strukturës, si dhe përshkrimeve të punës së Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit²⁰. Aktiviteti 2.1 <i>Ngritja e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në njësinë administrative Krujë</i> <i>Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura:</i> ✓ <i>punonjës social - 1 (shitesë)</i> ✓ <i>punonjës i mbrojtjes së fëmijës - 1 (shitesë)</i> ✓ <i>administrator shoqëror- 3</i> Aktiviteti 2.2:	Drejtoria e ndihmës ekonomike dhe shërbimit social Drejtoria juridike	Nëntor-dhjetor 2022	Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore; Rregullorja e Bashkisë Krujë përmban përshkrim të ri pune për strukturën e Nj.V.N.R në njësinë administrative dhe çdo specialisti sipas parashikimeve ligjore;	-Stafi i NjVNR në çdo njësi administrative, që do të ketë role dhe funksione të shprehura qartë në rregullore dhe kontratën e tyre të punës. - Të gjithë individët në nevojë për shërbime që përfitojnë si përmes shërbimeve parashoqërore që ofrohen nga niveli i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, ashtu edhe përmes rritjes së efikasitetit të strukturës të organizuar në përputhje me kriteret ligjore.	Bashkia Krujë	16.800.000	Sekretari i Përgjithshëm

²⁰ Shih rekomandimet 3-8, faqe 32-33, Raporti i Vlerësimit të Nevojave

<i>Ngritja e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në njësinë administrative Fushë-Krujë</i> <i>Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura:</i> ✓ <i>drejtues i njesisë</i> ✓ <i>punonjës social - 2 (1 shtesë)</i> ✓ <i>punonjës i mbrojtjes së fëmijës - 1</i> ✓ <i>administrator shoqëror- 2</i> Aktiviteti 2.3 : <i>Ngritja e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në njësinë administrative Thumanë</i> <i>Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura:</i> ✓ <i>punonjës social - 1 (shtesë)</i> ✓ <i>punonjës i mbrojtjes së fëmijës - 1</i> ✓ <i>administrator shoqëror- 3</i> Aktiviteti 2.4 : <i>Ngritja e Njesisë së</i>							
---	--	--	--	--	--	--	--

<i>Vlerësimi të Nevojave dhe Referimit në njësinë administrative Nikël</i> <i>Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura:</i> ✓ <i>punonjës social - 1 (shitesë)</i> ✓ <i>punonjës i mbrojtjes së fëmijës - 1</i> ✓ <i>administrator shoqëror- 2</i> Aktiviteti 2.5: <i>Ngritja e Njësise së Vlerësimi të Nevojave dhe Referimit në njësinë administrative Bubq</i> <i>Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura:</i> ✓ <i>punonjës social - 1 (shitesë)</i> ✓ <i>punonjës i mbrojtjes së fëmijës - 1</i> ✓ <i>administrator shoqëror- 1</i> Aktiviteti 2.6 : <i>Rishikim i përshkrimit të punës njësia administrative Cudhi:</i> ✓ <i>administrator</i>							
--	--	--	--	--	--	--	--

shoqëror- 2							
Objekti i specifik 2: Ngritja e kapaciteteve të stafeve në ushtrimin e detyrave funksionale dhe menaxhimin e rasteve sociale							
Aktiviteti 1. Trainim i stafit të strukturës përgjegjëse të shërbimit social në Bashki. <i>Trainimet do të zhvillohen gradualisht gjatë periudhës të zbatimit të planit dhe duhet të kenë në fokus</i> ✓ <i>Planifikimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror;</i> ✓ <i>Hartimi i sistemeve për të mbështetur menaxhimin, implementimin, komunikimin dhe përgjegjësinë;</i> ✓ <i>Monitorimi dhe vlerësimi;</i> ✓ <i>Puna me shërbimin jopublik, krijim rrjeti komunikimi dhe bashkëpunimi për ofrim</i>	Drejtoria e ndihmës ekonomike dhe shërbimit social	2024 2025 2026 2027	Numri i trainimeve të zhvilluara në përputhje me fushatat e identifikuara për ngritje kapacitetsh; Numri i pjesëmarrësve në trainim në përputhje me rolin dhe funksionin që kanë; Praktika pune të përmirësuara në vijim të trainimeve si rezultat i kapaciteteve të rritura dhe shprehive të fituara nga trainimet;	6 punonjës të strukturës së shërbimit social në Bashki që marrin njohuri, shprehi praktike dhe rrisin kapacitetet në drejtëm të planifikimit, monitorimit, buxhetimit dhe drejtimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Individët dhe grupet në nevojë pëfitojnë nga rritja e kapaciteteve të stafeve të dedikuara e për rrjedhojë rritjes së efikasitetit në drejtimin dhe menaxhimin në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.	Bashkia Krujë Partneritet me SHSSH dhe organizata joqeveritare	400.000	Sekretari i Përgjithshëm

<i>shërbimesh dhe referime rastesh urgjente.</i> ✓ <i>Prokurimi i shërbimeve të kujdesit social;</i> ✓ <i>Hartimi i projekteve</i> ✓ <i>Buxhetimi i shërbimeve sociale</i>							
Aktiviteti 2. Trainim i stafeve të Nj.V.N.R. ✓ <i>Njohuri mbi paketën legjislative të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe mbrojtjes së grupeve vulnerabël.</i> ✓ <i>Teknika të menaxhimit të rasteve sociale.</i> ✓ <i>Trainime specifike të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve për shërbimin e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror, masat e mbrojtjes.</i> ✓ <i>Trainim i punonjësve social në</i>	Drejtoria e ndihmës ekonomike dhe shërbimit social	2024 2025 2026	Numri i trainimeve të zhvilluara në përputhje me fushatat e identifikuar për ngritje kapacitetesh; Numri i pjesëmarrësve në trainim në përputhje me rolin dhe funksionin që kanë; Praktika pune të përmirësuara në vijim të trainimeve si rezultat i kapaciteteve të rritura dhe shprehive të fituara nga trainimet;	25 punonjës të NjVNR në njësitë adminsitrativ të Bashkisë Krujë që rrisin njohuritë, shprehitë praktike në zbatimin e legjislacionit dhe menaxhimin e rasteve sociale dhe për rrjedhojë rrisin efijencën në punën e tyre. Individët dhe grupet në nevojë pëfitojnë nga rritja e kapaciteteve të stafeve të dedikuara për shërbimet sociale. në çdo njësi administrative.	Bashkia Krujë në partneritet me SHSSH, ASHMDF, organizata joqeveritare me ekspertizë në fusha specifike;	400.000	Sekretar i Përgjithshëm

<i>mënyrë të veçantë për çështjet e dhunës në familje.</i>							
--	--	--	--	--	--	--	--

QËLLIMI 2- ZHVILLIMI I QASJES NDËRSEKTORIALE NË MENAXHIMIN E RASTEVE SOCIALE

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	PËRFITUESIT	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Objektivi specifik 1: Forcimi i koordinimit dhe qasjes ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijëve							
Aktiviteti 1. Krijimi i bazës së të dhënave me pikat e kontaktit të: ✓ <i>Institucioneve publike në nivel lokal (polici, prokurori, gjykatë, shëndetësi, arsim)</i> ✓ <i>Institucioneve publike në nivel rajonal dhe kombëtar (Ministritë e linjës, SHSSH, Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e fëmijës etj)</i> ✓ <i>Ofrues shërbimesh publike dhe jopublike në nivel lokal, rajonal, kombëtar)</i>	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës	Janar 2023	Data base e ngritur dhe përmban të dhëna me pika kontakti për çdo institucion lokal, rajonal, kombëtar, organizata ofruese shërbimesh në nivel rajoni; Aksesit në bazën e të dhënave i stafit në nivelin e Bashkisë dhe NjVNR sipas fushës së përgjegjësisë;	Punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe punonjësit e institucioneve që kanë përgjegjësi ligjore për zbatimin e ligjit "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", si dhe ofruesit e shërbimeve për fëmijë, që koordinojnë e ndërveprojnë për mbrojtjen e fëmijëve.	Bashkia Krujë	<i>Kosto te perfshira ne punen e stafit. Nuk ka kosto shtese.</i>	Drejtoria e ndihmës ekonomike dhe shërbimit social

